

INTERVISTË ME MOMÇILLO TRAJKOVIQIN

Çagllavicë | Data, 5 shkurt, 2019

Kohëzgjatja, 176 minuta

Të pranishëm:

1. Momçillo Trajković (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Kaltrina Krasniqi (Intervistuesja/ Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal,
 () - komunikim emocional
 {} - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë,
 [] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin
 Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

Pjesa e Parë

Erëmirë Krasniqi: Për fillim nëse mund të prezantoheni, na jepni të dhënat tuaja bazike, ku keni lindur, emri dhe mbiemri dhe kujtimet tuaja më të hershme, familja juaj etj.?

Momçillo Trajković: Unë quhem Momçillo Trajković, i babait Aleksandër dhe nënës Milica. Babain e kam nga këtu, kam lindur pikërisht këtu ku po flasim sot, ku kam lindur unë, vëllau im i vogël dhe dy motrat e mia. Unë jam i pari, dy motrat pastaj vëllau. Dhe këtu jemi rritur, këtu kemi jetuar, ja edhe sot unë jetoj këtu. Babain e kam pasur teknik të bujqësisë, ka punuar në terren dhe shpesh nëpër Kosovë. Për shembull, ai e ka udhëhequr mbjelljen e pemëtarisë në Ferizaj, “Mladost” [Rinia] ashtu është quajtur, dhe më kujtohet kur kam qenë i vogël nga respekti për të, shpesh kur ata nga Ferizaji, “Mladosti” bartnin pemë vinin këtu dhe ia sillnin babait disa gajbe nga respekti që dikur ka punuar.

Nënën e kam nga Llaplla Sella, është fshat fqinj këtu, Milica. Edhe nëna edhe babai im janë nga familjet partizane dhe kjo ka qenë arsyeja pse ata janë martuar diku në vitet e ‘50-ta, në shkurt, në muajin janar-shkurt. Atëherë janë martuar dhe unë u linda më 5 nëntor të vitit 1950. Unë këtu e kam përfunduar shkollën fillore, katër klasë këtu në Çagllavicë. Kurse nga klasa e pestë deri të tetën kam shkuar në Llaplla Sellë në shkollë këtu poshtë. Pas përfundimit të tetëvjeçares, unë jam regjistruar në shkollën ekonomike dhe e kam përfunduar shkollën e mesme ekonomike.

Erëmirë Krasniqi: A mund të flasim edhe pak për fëmijërinë tuaj, me më shumë detaje?

Momçillo Trajković: Po, si jo.

Erëmirë Krasniqi: Të mos ecim kaq shpejtë.

Momçillo Trajković: Mua më kujtohet, pasi që babai im ka qenë teknik i bujqësisë, thashë ka punuar në terren, ai për një kohë ka punuar në veterinari sta... në stacionin bujqësor, diku në drejtim të Kolovicës. Aty ka qenë ai stacioni, dhe aty madje kemi jetuar për një kohë. Dhe ajo fotografi, fotografia që ua dhashë është e asaj periudhe kur babai dhe nëna më kanë dërguar tek fotografi për të më fotografuar si fëmijën e parë mashkull. Fëmija i parë, unë jam më i madhi.

Erëmirë Krasniqi: E ku? Në Prishtinë?

Momçillo Trajković: Po, po kjo është në Prishtinë, në Prishtinë, te ndonjë fotograf. Nuk kam pyetur, por e di që ka qenë në Prishtinë. Dhe më kujtohet nëna më tregonte atëherë që... nga ajo pjesë më kujtohet se nëna më tregonte që kemi jetuar aty dhe njëherë ka përgatitur drekën me breshkë, ajo thotë “zhelko”, “zhelko” e thërrasim. Ka përgatitur gjellë me mish të breshkës dhe kjo më kujtohet nga tregimi e nuk më kujtohet a kam ngrënë apo jo. Me siguri kam ngrënë sepse as nuk e kam ditur për çka bëhet fjalë, por kështu ka qenë.

Pastaj prapë jemi kthyer këtu, këtu kemi jetuar, ne kemi qenë mjaft të varfër, nuk kemi qenë të pasur. Gjyshi im Stavra, babai i babait tim, ai ka qenë në Amerikë. Ka jetuar në Amerikë deri ‘18-tën, shtatë vite. Nga viti 1911 deri 1918 ka qenë në... jo, deri në vitin ‘19 ka qenë në Amerikë, në Çikago. Përndryshe e ka folur gjuhën angleze, sepse ka punuar diku dhjetë vite ka qenë atje. Kur ka ardhur, kishte fituar para të mira. Por, i ka ndodhur diçka e tmerrshme, një shokut ia ka dhënë një pjesë të parave që t’i dërgojë këtu dhe ai shoku paratë që i ka fituar duke punuar atje, thjesht ia ka marrë dhe kurrë nuk ia ka kthyer. Për këtë arsye ka pasur mjaft probleme, madje më vonë është sëmurë dhe ka vdekur diku në vitin ‘37.

Babai im ka lindur në vitin ‘21. Gjyshja ime është nga Dobrotini, nga Lipjani, tani tek Dobrotini i Lipjanit dhe ajo gjithmonë më ka folur për gjyshin të cilin, të cilin ajo e ka pritur tetë vite. Kur gjyshi ka shkuar për Amerikë, gjyshja është fejuar me të {prek gishtin e vet}, ai është fejuar me gjyshen. Por, kur gjyshi është kthyer si amerikan, thjesht, ka pasur mjaft para, ka qenë njeri tjetër, njeri modern, nuk është ai fshatari që është larguar nga këtu. Dhe ka pasur probleme të mëdha, kjo më ka mbetur nga fëmijëria, dhe më vonë kur kam folur me gjyshen dhe me babain të gjithë në familje kemi folur për këtë.

Gjyshja ka qenë e imët, të mos them për gruan që ka qenë e shëmtuar, por një grua e imët, nuk ka qenë... gjyshi ka qenë trupmadh dhe ajo nuk ka qenë për të, ashtu si thuhet. Gjyshi është munduar ta linte për tu martuar me fqinjen tonë, këtu përballë ka jetuar. Pastaj kanë ndërhyrë kushërinjtë dhe në një mënyrë e kanë qetësuar gjyshin dhe kështu gjyshi është martuar me gjyshen. Me të i ka bërë dy djem dhe katër vajza, gjashtë fëmijë i ka lindur. Por, burri i vdes në vitin ‘37. Babai im i ka pasur 14 vjet kur i ka vdekur babai, ka qenë më i madhi dhe pastaj katër motra dhe një vëlla dhe gjyshja e vjetër. Jo gjyshja e vjetër, gruaja, nuk ka qenë atëherë e vjetër, gruaja.

Pastaj, edhe pse kanë pasur mjaft tokë kanë pasur problem sepse diku para Luftës së Parë Botërore, pas vdekjes së këtij gjyshit, digjt shtëpia dhe e gjithë pasuria digjet. Aq janë shkatërruar sa që fshati ka sjellur ndihma në mënyrë që ata të mbijetonin. Megjithatë, edhe pas kësaj ka filluar, krahas kësaj kurrë nuk i’a kanë dalur të rimëkëmben. Prandaj ne pas luftës, kur kam lindur unë babai ka qenë punëtor në terren nuk kemi jetuar edhe aq mirë. Madje kemi qenë mjaft të varfër. Mëkujtohet ajo jeta fëmijërore,

a jo shtëpia që ka qenë këtu, aty ka filluar aty ka mbaruar. I ka pasur dy dhoma. Në njërin dhomë kuajt dhe lopët ndërsa në dhomën e madhe flinim ne.

[Intervista është ndërprerë për shkak të problemeve teknike]

Sidomos atëherë ka qenë një grevë e madhe në Amerikë, dhe atëherë... për shkak të asaj grevës i kanë marrë punëtorët nga Evropa *streikbrechere*¹, të cilët kanë ardhur për t'i zëvendësuar ata. Por, gjyshi im ka shkuar para grevës dhe shumë nga këtu, shumë njerëz nga Çagllavica kanë shkuar para grevës, para asaj grevës. Por gjatë kohës së grevës ka qenë një përpjekje që një numër i njerëzve të shkoj atje dhe t'i zëvendësoj *streikbrechere*, grevistët, *streikbrechere*, t'i quaj grevistë.

Dhe unë e kam në librin tim fotografinë e një të moshuari nga këtu... se si, jo Sherafini... do të më kujtohet. Rista, Rista Mitiq, që është nisur për Amerikë dhe dy herë ka shkuar në Amerikë dhe dy herë ka arritur deri në Çikago dhe dy herë e kanë kthyer prapë. Kur ka mbërritur në Çikago, pasi që atje i ka pasur vëllezërit, vëllezërit kanë ardhur jo... jo, ka mbërritur në Nju Jork. Vëllezërit e tij nga Çikago kanë ardhur në Nju Jork për ta pritur dhe për ta kthyer mbrapa. Të gjithë ata *streikbrechere* që duheshin t'i zëvendësonin grevistët është dashur të kthehen mbrapa.

Dhe kështu xhaxhi Rista dy herë ka shkuar deri në Amerikë dhe më ka treguar që ka qenë një muaj në anije, thoshte, "Anije e madhe ka qenë". Njëkatën e parë kafshët, pasi që po udhëtojnë një muaj duhet të kenë diçka për të ngrënë, kanë qenë anije me avull. Kati i parë kafshët, i dyti depoja dhe mallrat, kati i tretë njerëzit {përshkruan me duar}. Njerëzit shkojnë atje. Dhe thonë që kanë shkuar nga këtu...

Erëmirë Krasniqi: E ku e kanë marrë atë anije?

Kaltrina Krasniqi: E varkën ku?

Momçillo Trajkoviç: Tani unë, prej këtu kanë shkuar. Kanë shkuar deri në Shkup, pasi që atëherë nuk ekzistonte hekurudha Prishtinë-Beograd, e as Prishtinë-Nish. Por kanë shkuar nga Fushë Kosova deri në Shkup dhe nga Shkupi deri në Nish pastaj lartë për në Beograd dhe pastaj nga Beogradi prapë me tren kanë arritur deri në Bremen në Gjermani. Bremen ka qenë vendi ku kanë hipur në anije nga Bremeni, pastaj ai tregonte, "Nga Bremeni lundrojnë një muaj në mënyrë që të mbërrijnë atje". Kjo është ajo, kjo më kujtohet. Kjo është interesante.

Kur gjyshi im, kur gjyshi im u kthye këtu, babai im ka qenë njeri ndryshe nga të gjithë këta njerëzit tonë këtu. Ky populli ynë, serbët e vjetër, janë mjaft, mjaft të them popull i paarsimuar dhe e kanë atë mentalitetin, një mentalitet të çuditshëm, mentalitet i popullit që armë kryesore e ka durimin. Pra, mund të duroj çkado, prandaj edhe ka mbijetuar. Dhe sot këtu pas gjithë asaj që ka ndodhur, ka

¹ Në gjuhën gjermane: *Streikbrecher*. Follësi e përdor këtë term për të përshkruar punëtorët të cilët kanë shkuar në Çikago për të zëvendësuar punëtorët në grevë.

mbetur këtu populli i vjetër sepse mund të duroj. Hallet, problemet, i tejkalon të gjitha dhe duron. Ai e ka duruar epokën turke, pra ky popull kurr nuk ka lëvizur që këtu, lëvizja më e madhe ka ndodhur pas vitit '99. Pra... përndryshe para vitit '99 nuk ka lëvizur.

Këtu, përndryshe në Kosovë, nuk e di sa e dini në Kosovë kanë jetuar serbët, jetojnë ende rreth qyteteve të mëdha. I gjithë rrethi i qyteteve në Kosovë janë fshatra serbe. Ja për shembull Çagllavica, e keni atje edhe Fushë Kosovën shumica është serbe dhe Caravodica edhe Kastrioti ka qenë serb, serb në kuptimin e popullit që e ka pasur, ka qenë Uglarë, Bresja, e keni atje Kuzminin, e keni Dobri Dubin, pastaj e keni Preocin, Llapllasellën, Çagllavicën, Graçanicën, Matiçanin, Hajvalinë që është vend minatorësh, më vonë është bërë vend ku kanë ardhur shqiptarët. Pra, të gjitha rrethet, nëse do edhe Gjilani, në Gjilan të gjitha fshatrat përreth janë... Shilova, Parteshi, të gjitha fshatrat janë... do të thotë serbët kanë jetuar në fshatra. Por përse? Edhe në Prizren rreth Prizrenit. Në Ferizaj njëjtë, në Pejë njëjtë...

Erëmirë Krasniqi: Përse nuk kanë jetuar në qytet?

Momçillo Trajkoviq: Qyteti ka qenë, qyteti ka qenë jashtë më shumë kanë jetuar në male, turqit kanë jetuar në qytete, qytetet kanë qenë turke. Pastaj, serbët dhe shqiptarët, ata kanë qenë zanatlinjë, zanatli ka qenë dikush, disa familje kanë jetuar. Kjo është ajo pjesa serbe dhe shqipe, dhe ajo shumica serbe, e më pak shqiptare kanë jetuar në qytete. E që... pasi që turqit është dashur ta mbledhin atë pasurinë e vet, i kanë pasur qipqijat e veta, kështu i kanë thirr njerëzit e vet të cilët kanë punuar për ta. Të gjithë, të gjithë ata serbët që kanë qenë këtu e kanë fituar tokën në të cilën kanë punuar. Ajo tokë nuk ka qenë e tyre, ajo ka qenë tokë turke dhe kjo toka ku jemi ne të gjitha këto kanë qenë tapija turke. Kurse serbët, dhe shqiptarët por po flas për atë që e di më mirë, edhe shqiptarët nuk e kanë pasur tokën e tyre burimore sepse okupimi turk ka vazhduar për 500 vite. Por, aga turku, ai e ka të gjithën, e gjithë Çagllavica ishte e tij, ai e ka shërbëtorin e vet, shërbëtorët e vet, qipqijat e veta që punojnë për të. I jepin, nuk e di, pjesën që ju takon në fund. Dhe kështu.

Eh, kur ne, por edhe shqiptarët, ata shqiptarët dhe serbët e vjetër, ata tokën e kanë fituar, kur, kur Kosova është shlyer nga turqit. Atëherë çdo agë, secili shërbëtor, qipqijët e turqve, serbi dhe shqiptari që e ka punuar tokën, ai atë tokën kur turqit kanë ikur e ka mbajtur për vete. Pra, kjo është, në këtë mënyrë, përndryshe pas të gjitha tapive turke nuk ka asnjë dëshmi që ka qenë pronë e dikujt. Kështu edhe është jetuar, më vonë është bërë kadastrë, tapiat kanë hyrë në fuqi, që të dihet e kujt është toka dhe si.

Erëmirë Krasniqi: Me çka është marrë më së shumti komuniteti serb?

Momçillo Trajkoviq: Bujqësi. Serbët janë marrë me bujqësi dhe blegtori. Shqiptarët janë marrë më shumë me blegtori. Pra, serbët kanë jetuar këtu në këtë vend në tokën pjellore, kjo është tokë pjellore, kjo është e dhimbshme kur shihet që gjithë këto ndërtesa dhe shtëpi janë ndërtuar në tokat më

pelllore. E dini, askush nuk pyet ku do të ndërtojë, vetëm shkojnë dhe ndërtojnë. Përndryshe në librin e Anastasit Urosheviq, diku pas Luftës së Dytë Botërore, i ka kaluar të gjitha vendet dhe ka bërë regjistrimin e popullsisë, kurse për familjen time thotë që nuk ka të dhëna se nga kemi ardhur ne në Çagllavicë, sepse Çagllavica është lagje e re.

Çagllavica nga shekulli XVIII, 1700... Çagllavica është ndërtuar pas zhvendosjes së dytë të serbëve. Pra, ajo është ndërtuar në vitin 1737 ka qenë ajo zhvendosja e dytë e serbëve, pas luftës austro-turke. Atëherë, kur austrianët janë nisur, ajo është lufta e dytë austro-turke, i pari ka qenë në vitin 1688, kurse në vitin 1690 ka qenë shpërngulja e parë serbe në Carnovicë, kështu thotë historia jonë. Dhe kur austrianët kanë filluar sulmin ndaj turqve që t'i hiqnin nga ky vend, serbët e Rashkës e këtej janë kryengritur, dhe kanë kaluar në anën e austrianëve në mënyrë që të shliroheshin nga turqit.

Megjithatë, turqit janë kthyer dy herë... jo, jo, ok. Dy herë turqit kanë mbërritur deri në Jankoviç, deri te Hani i Elezit, aty kanë ardhur austrianët dhe janë kthyer mbrapa. Kur janë kthyer mbrapa nuk kanë menduar për njerëzit që kanë qenë në anën e tyre. Të gjithë njerëzit që kanë qenë në anën e Austrisë turqit i kanë vrarë dhe për shkak të frikës ka ardhur deri te zhvendosja e madhe serbe nga këtu. Do të thotë dy herë ka ndodhur kjo dhe zhvendosja e tretë ka ndodhur më 1999 kur ky popull i ka besuar Millosheviqit që do ta zgjidh këtë problem. Pra, tri herë ky popull ka dalë naiv dhe ka pësuar keq. Tri herë ka pësuar keq.

Atëherë familja ime, sipas asaj, pasi që unë hulumtoj dhe merrem me këtë. Familja ime, përndryshe këtu na thërrasin Stashiq, mbiemri ynë burimor Stashiq dhe neve na thërrasin Stashiqët, kjo është familja jonë. Ka këtu Terziqa, ka këtu Laziqa, këto janë fise sikur janë te ju *fiset* [e thotë të shqip] kështu ka edhe tek ne. Kur të vini këtu dhe pyesni për Stashiqët, kush janë Stashiqët, ata do të thonë, "Cilët?" Ne festojmë festën, dy, i kemi dy festa. Do të thotë, Shën Gjergjin, më 16 nëntor dhe është Shëngjergji, më 6 maj. Ato janë festa dhe nënfesta, janë festa verore dhe dimërore. Duke parë unë këtë dhe që jemi Stashiq, unë kam ardhur deri tek të dhënat që ne në fakt kemi ardhur nga rrethi i Klinës, pra nga Drenovci tek Klina. A e dini ku është Drenovci? Eh, Drenovci, ne kemi ardhur afërsisht një mijë...pas shpërnguljes së dytë, në vitin 1737. Atëherë...

Përndryshe në Çagllavicë të gjitha fiset janë serb që kanë ardhur këtu ose nga Javori në Istog, ose nga vendi... do të thotë pjesa më e madhe e njerëzve nga ai vend kanë ardhur këtu. Prandaj, po theksoj, që e kemi mbiemrin Stshiq në Drenovc i gjithë fshati është Stashiq, festojnë festat e njejta sikur ne në Çagllavicë, të gjithë kanë ardhur nga ai vend. Po supozoj, nuk mund të theksoj, por po supozoj që prejardhja jonë është nga Klina, pra nga Drenovci tek Klina.

Kaltrina Krasniqi: A keni vëllezër dhe motra?

Momçillo Trajkoviç: E kam, e kam motrën. Unë jam më i madhi, motra e dytë, motra e tretë dhe vëllau më i vogël. Motra jeton tek Umagu, në Bujamë, Bujama tek Umagu, atje jeton, atje ka familjen atje

është martuar në kohë të vet. Motra e dytë jeton, jetonte në Prishtinë, tani jeton në Vrnjačka Banja në Verbak, në Krlevë, afër Krlevës. Pikërisht dje, pardje kam qenë atje, kam buajtur, kam shkuar ta shoh motrën. Edhe vëllau më i vogël jeton aty {tregon drejtimin me dorë} por e ka shtëpinë në Beograd, përkatësisht në Barevë, pasi që të gjithë në një mënyrë pas asaj që ka ndodhur kanë bërë rezerva dhe fatkeqësisht njerëzit po ikin.

Unë po mundohem sa është e mundur... ja tani është aty ai shqiptari që ka ardhur dhe tani unë jam serb dhe nga këtu... dhe përballë [ka serbë]. Dhe po mundohemi të mirëkuptohemi, nuk duhet... falë zotit nëse kemi ndonjë tokë do ta shesim por nuk duhet t'i shesim tokat. Unë nuk mundem, unë në Beograd kam banesë, unë nuk mund të jetoj atje. Unë qëndroj atje dy ditë dhe ditën e tretë iki dhe kthehem këtu. Pasi që i kam fëmijët atje në Ushqë, gruaja është atje për momentin, përndryshe unë dhe gruaja jetojmë këtu. Fëmijët vijnë kur të munden.

Njëra vajzë është martuar në Beograd për një koleg, ajo ka qenë gazetare, së pari për BK televizionin, pastaj këtu ka raportuar për B92, ajo ka qenë për televizion, ka punuar për B92, pastaj u martua për atë kolegun me të cilin ka punuar dhe tani është në radio S në Beograd, udhëheq programin informativ-politik është gazetare dhe spikere.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë fshati ishte Çagllavica?

Momçillo Trajković: Çagllavica ka qenë një... vetëm të të tregoj që e kam një vajzë më të re e cila u martua këtu në Çagllavicë dhe ata kanë shkuar në Nish atje jetojnë edhe djali...

Erëmirë Krasniqi: Do të flasim edhe për këtë më vonë.

Momçillo Trajković: Çagllavica ka qenë një fshat interesant, e rëndë për jetën. Përse rëndë? Këtu nuk ka të ashtuquajtur ujë të mirë, nuk ka ujë të pijshëm. Në Çagllavicë si më kujtohet mua kanë ekzistuar tre bunarë, tre, njëri ka qenë këtu përballë ku gjendet kjo lagje e re, fshati zvicran, aty ka qenë një bunar dhe ne kemi shkuar atje të marrim ujë për pije. Bunari tjetër ka qenë në qendër të fshatit atje, dhe i treti tek një fshatar privat që e ka pasur në oborin e tij bunarin. Dhe të gjithë, pra, për të ardhur të gjithë tek uji i pijshëm, të gjithë kemi shkuar tek ata bunarë.

Ekziston madje tregimi që kur vajza dëshiron të martohet nëna e nëm të bijën, "Dhashtë zoti që në Çagllavicë të martohesh". Nëna ime e ka pasur për zakon të thotë, që duart i janë këputur duke bartur ujë, duke bartur ujë gjithë jetën. Sepse ne kemi aty bunar, por është i njelmët, ujë i njelmët. Dhe nuk e pranon sapunin, nuk shpërlahet. Vetëm lopët kanë mundur ta pijnë, por larja, shpërlarja, e gjithë kjo është dashur të jetë, është dashur uji të merret nga bunari. Dhe tani mund ta paramendoni sa shtëpi ka, të gjithë shkonin atje për të marrë ujë.

Atëherë Çagllavica e ka pasur lloqin e rëndë, ai lloq ka qenë shumë i ngjitsëm. Ajo është tokë e zezë, tokë e rëndë dhe është si ngjitës kur bie shi... ka qenë e tmerrshme. Këtu kanë qenë, këtu nuk ka pasur as kalldërm, mua më kujtohet kjo, as kalldërm nuk ka pasur. Kurse, gardhi ka qenë, a e dini çka janë therrat? Therrat, ato kanë qenë gardhe, pastaj kanë ardhur tarabat, pastaj... tek serbët, dhe te një numër nuk ka pasur mure, këtë nuk e kanë serbët, siç e kanë shqiptarët me mure dhe të tjerët. Por, në një pjesë te pronarët ka pasur, pronarët serbë kanë pasur dyer të larta dhe mure. Por, kjo tek të tjerët nuk ka ekzistuar. Më vonë vijnë tarabat. Mua më kujtohet këtu nuk ka pasur rrymë, mua më kujtohet kur këtu ka pasur llampa.

Erëmirë Krasniqi: Kur ka ardhur rryma?

Momçillo Trajković: Paj, viteve të '60-ta ka ardhur këtu rryma, kjo më kujtohet. Përndryshe, kjo rrugë para kësaj ka shkuar për në Shkup, E ka ndërtuar ushtria dhe në Çagllavicë ka qenë kazerma, këtë rrallë kush e di. Në Çagllavicë ka qenë kazerma pikërisht aty ku tani gjendet fshati zviceran. Ai bunari më kujtohet kur ushtria e ka bërë atë kazermën, e ka bërë për shkak të bunarit, për shkak të ujit të mirë dhe pastaj bunari ka qenë një pjesë në kazermë një pjesë këndeje në mënyrë që edhe fshatarët të mund të merrnin ujë. Dhe ajo ushtria ka qenë aty për disa vite deri sa nuk është bërë, derisa është përfunduar rruga. Ajo rrugë ka shkuar, rruga e mëhershme kah Llaple Sello nëse e dini, kjo rruga kah Llapla Sella. Kurse më vonë është bërë kjo rruga e cila tani shkon poshtë kah HIB Petroli siç quhet poshtë. Ajo është rruga e re që ka shpjer deri në Shkup, kurse kjo rrugë të ka shpjer deri në Prizren. Kjo është rruga e vjetër e Prizrenit.

Erëmirë Krasniqi: Sa vite keni jetuar këtu me familjen tuaj?

Momçillo Trajković: Unë kam jetuar deri '83-'84 deri sa se kam fituar banesën në Prishtinë, pastaj kam jetuar në Prishtinë.

Erëmirë Krasniqi: E në fillore... shkollë të mesme ku keni qenë?

Momçillo Trajković: Në Prishtinë, Shkolla Ekonomike. "Xhevdet Doda" ku, ka qenë më herët Shkolla Ekonomike, ku tani është katedralja, aty ka qenë Shkolla Ekonomike. Aty kam shkuar dy vite, pastaj Shkolla Ekonomike është zhvendosur këtu, ku është sot, mendoj ku është Shkolla e Bujqësisë përballë kazermës "Adem Jashari", përballë kazermës aty ka qenë Shkolla Ekonomike, aty i kam përfunduar katër klasë. Pas kësaj e kam regjistruar juridikun...

Erëmirë Krasniqi: A keni udhëtuar?

Momçillo Trajković: Si jo? Unë për çdo ditë udhëtoja. Dhe jemi apo... si quhet ai spitali "Rezonanca" apo jo? Nëpër atë kodër poshtë është një lum zbrisnim kah lumi dhe vinim në shkollë.

Erëmirë Krasniqi: Cili lum është ai?

Momçillo Trajković: Është Prishtevka. Ajo është mbyllur. Ajo është Prishtevka nëpër të cilën rrjedh lumi Matiçka, Matiçanka, Prishtevka dhe pastaj vazhdojnë në drejtim të Sitnicës. Ajo rrjedh nëpër Uglarë, shkon në Bresje dhe rrjedh në Sitnicë. Ne në vitet e '60-ta, '56-ta, babai im ka punuar në Shtime pastaj pasi që nuk ka mundur të udhtojë, ne këtu mbetëm vetëm... pastaj dy motra, vëllau i vogël nuk ka qenë i lindur ende dhe ne shkojmë të jetojmë në Shtime, pasi që ai ka punuar në korporatë, korporata Shtime, korporata bujqësore. Dhe unë kam shkuar në klasën e parë të shkollës fillore pasi që, shkollën e kam pasur në kodër në Shtime, atje ka qenë kisha dhe shkolla. Atëherë, tani nuk e di. Kisha dhe shkolla më kujtohet që gjithmonë kam shikuar nga klasa dhe e kam parë kishën dhe aty kam shkuar, kam filluar të... kam filluar gjysëm vjetorin e parë.

Në gjysëm vjetorin e parë u sëmura unë dhe një shoqe e klasës, është quajtur Danica, nga difteria. Atëherë nuk ka pasur kulturë shëndetësore, nuk ka pasur. Dhe na dërgojnë në spital, në Prishtinë. Spitali infektiv, spitali infektiv nuk e di a është sot atje, diku nga hekurudha dhe lartë disi, në Dragodan diku. Eh, aty na dërguan. Dhe më kujtohet, pasi që ka pasur tollovi në spital, unë dhe shoqja ime flenim këmbë më këmbë, ajo kokën andej, unë kokën këndej {spjegov me duar} ashtu kemi fjetur, fëmijë. Sa? Shtatë më shumë nuk i kam pasur. Dhe një mëngjes po vijnë këta të spitalit dhe po e marrin atë. Unë po i pyes, "Ku po shkoni?" Thotë, "Duhet ta lajmë". Por, e gjora, pastaj kam kuptuar se ajo... Unë jam frikësuar që edhe mua do të më lajnë e di? Unë i turpshëm, si? Dhe unë e kuptoj pas disa ditësh që ajo në fakt ka vdekur. Dhe kështu e kanë marrë dhe e kanë dërguar. Dhe më kujtohet Danica dhe babai i saj më vonë dhe kështu me rradhë, e kështu me rradhë.

Erëmirë Krasniqi: Si e keni mbijetuar ju sëmundjen?

Momçillo Trajković: Nuk e di. Unë nuk e di, kam mbijetuar në shtëpi më kanë... dhe pastaj babai ka marrë vendim që ne të kthehemi prapë në Çagllavicë. Dhe gjysëm vjetorin e dytë të klasës së parë e kam vazhduar në Çagllavicë, aty ku është Shtëpia e Kulturës, aty atëherë ka pasur shkollë dhe aty kam qenë në shkollë.

Erëmirë Krasniqi: Me çka është marrë nëna juaj?

Momçillo Trajković: Nëna ime ka qenë amvise. Amvise, grua, burri në teren ajo vetëm me ne. Dhe kurrë nuk do ta harroj kur na është djegur shtëpia, kështu... gjeldeti dhe pastaj... lopët kanë dalë nga ajo dhoma tjetër, pastaj ne jemi zgjëruar pak, apo jo? Kështu, edhe shporetit ka qenë në atë dhomën e vogël, kurse ajo tjetra ka qenë dhomë e fjetjes. Dhe nëna ime e mbyllte oxhakun me lecka {tregon me duar}. Dhe ajo ka shkuar për Prishtinë, ne e kemi ndezur zjarrin, kemi luajtur si fëmijë, unë kam qenë i vogël, hyra në atë dhomën e fjetjes dhe shoh që brenda ka tym. Pastaj fillon, e ndezi dritën, çfarë drite, krejt tym, nuk shihet asgjë (qesh). Dhe mu kujtua se si, se si... kemi shpëtuar të gjithë sëbashku, kemi

marrë batanije, jorganët i kemi nxjerrë jashtë që të mos digjen. Por dikush prej fqinjëve ka ardhur dhe e ka mbyllur. Kjo më është dukur interesante.

Ne kemi pasur, ky oborri ynë ka qenë përplot me kumbulla, ka pasur me qindra copë, me siguri ka pasur ndërmjet rreshtave edhe patate që i ka mbjellur nëna, pastaj fshisa të dorës, a e dini çfarë janë fshisat? Dhe lodrat tona, pasi që atëherë ato kanë qenë lodra tona, apo jo? Unë kam qenë, unë e punova një traktor dhe shirëse nga patatja dhe nga fshisa. E merr një fshisë dore dhe e vendos pataten, njërën dhe tjetrën anë dhe bëhen rrotat {përkthyer me duar}... eh, pastaj merrni litar dhe e lidh me traktor dhe mbledhim barë e punonim kinse me traktor *brrrr* {onomatopeike}, kurse motra dhe vëllau kinse makina *vuuuu* {onomatopeike}. Dhe sot e kësaj dite kur të takohemi flasim për këtë, kjo ka qenë shumë interesante.

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë religjioni pjesë e jetës?

Momçillo Trajkoviq: Jo, ka qenë, religjioni atëherë ka qenë i ndaluar, jo... e di që atëherë festat janë festuar në fshehtësi. Për kohë të gjatë... më vonë janë lejuar. Komunistët nuk kanë lejuar të festohen festat. Ka mundur të festohet 1 maji, 29 nëntori, këto ishin festat që i kanë festuar të gjithë. Unë jam i sigurt që as bajrami nuk është festuar, kështu që as festat nuk janë festuar të cilat... komunizmi në fillim ka qenë rigoroz, më vonë pak është lëshuar por kështu ka qenë.

Erëmirë Krasniqi: Ju e keni këtu në afërsi një kishë?

Momçillo Trajkoviq: Kanë filluar këtu ta ndërtojnë një kishë, por nuk ka përfunduar. Ajo kisha e tregon fatin e këtij populli. Kishën e bën populli që shkon. E dini dikush që shkon ndërton kishë, ajo dëshira që të mbetet. Kjo është ajo... tregon shumë mirë fatkeqësinë e këtij populli. Së pari, në vend se të bëhet kisha në qendër të fshatit këta qeveritarët nuk e lejojnë, sepse plani është që kjo një ditë të bëhet e shqiptarëve. Kisha pas shtëpisë së kulturës ku Thaçi e ka ndërtuar... kam dëgjuar së fundi, nuk e kam ditur që ai është aty, që ka rezidencë në Çagllavicë. Në atë vend ku ai ka ndërtuar, ku e ka bërë rezidencën, aty është planifikuar të bëhet kisha, por jo tani. Por, ai njeri e ka shitur, ka qenë një konflikt. Por pastaj nuk kanë lejuar përballë shtëpisë, as atje ku është këndi i lojrave, por, aq ka pasur presion sa që kisha ka filluar të ndërtohet në një kënd.

Ndërsa, kisha zakonisht duhet të ndërtohet ashtu si xhamia aty në qendër, ku është qendra. Kështu tani gjithçka është ftohur. Pra, kisha në kënd, populli i pa interesuar, kurse kishën ka filluar ta ndërtoj shteti. Kurrë, nuk e di si është me xhamia, por që kisha të mbijetoj, që ajo të mbijetoj, do të thotë që të respektohet, duhet ta bëj populli, duhet populli ta ndjej nevojën që ta ndërtoj. Nëse nuk e ndjen nevojën, nëse dikush ia ndërton kishën, mund t'ia bëj kishën më moderne por ajo do të mbetet e zbrazët. Dhe ky është fati, do të thotë e kam thënë, kishën e ndërton populli që ikën. Kështu. Çka do të ndodh, cili është fati a do të ndryshojnë disa gjëra dhe të bëhet më mirë, që të ndalet, tani për tani këtë nuk po e shoh. Dhe kjo është mjaft tragjike.

Erëmirë Krasniqi: Mund të kthehemi në vitet e '80-ta kur keni vijuar shkollën e mesme në Prishtinë, diçka më shumë lidhur me këtë...?

Kaltrina Krasniqi: Është shkollë e mesme, apo jo?

Momçillo Trajković: Si?

Kaltrina Krasniqi: Kur keni shkuar në Prishtinë, jeni punësuar apo... ?

Momçillo Trajković: Unë jam punësuar në vitin '78, por unë kam jetuar këtu, këtu ne e kemi pasur shtëpinë me vite, mirëpo këtu kam jetuar, këtu kemi... babai, vëllau. Unë jam martuar në vitin '72, jam martuar me 22 vjet, pastaj kam punuar në Këshillin Ekzekutiv të Kosovës, kam qenë... kam punuar në ministri, atëherë ka qenë sekretariati, diçka si Ministria e Punës.

Erëmirë Krasniqi: Çka keni studiuar?

Momçillo Trajković: Juridikun. E kam përfunduar juridikun, Fakultetin Juridik në Prishtinë. Aty e kam përfunduar Fakultetin Juridik pastaj e kam regjistruar Të Drejtën Ndërkombëtare në Beograd.

Kaltrina Krasniqi: Pse keni marrë vendim të studioni juridikun?

Momçillo Trajković: Nuk e di, më ka pëlqyer kjo, kjo më është përshtatur. Të gjithë, kur kam qenë i vogël më thoshin, "Ja ky avokati, ja ku është ky avokati" (qesh). Dhe po, babai im ka qenë orator, babai im ishte... e pamundur, ky populli ynë nuk ka aftësi për oratori, nuk ka aftësi për oratori siç janë njerëzit nga Mali i Zi dhe nga Peja. Malazetët, o njeri variant i gusllave {përshkruan me duar}, nëpërmjet gusllës e mësojnë Njegoshin dhe pastaj mund të flasin çfarë të dojnë, e dini vetëm shtojnë dhe e lidhin. Kurse, ky populli ynë këtu nuk është orator, kurse unë kam qenë, babai im është dalluar nga të gjithë. Për shkak se babai im është rritur deri në moshën 14 vjet me babain e vet të shkolluar. Babai që ka qenë nëpër botë. Pra, kjo ka lënë më së shumti gjurmë, pasi që babai im ka qenë më i madhi tek ai më së shumti [ka lënë gjurmë]. Dhe unë e kam trashëguar nga babai. Kam trashëguar nga babai edhe të gjindem, dhe thjesht të di çka dua, apo jo?

Erëmirë Krasniqi: Ju keni studiuar juridikun në Prishtinë, keni ardhur në Prishtinë apo këtu keni jetuar?

Momçillo Trajković: Po, po, unë kam jetuar këtu. Neve... Çagllavica është e njohur për qumësht. Pra, Çagllavica e ka ushqyer këtë pjesë të Prishtinës, Aktashin, atëherë nuk ka pasur të tjera, Bregu i Diellit, nuk ka qenë. Aktashi nga semafori e këtej deri te spitali, Çagllavica e ka ushqyer popullin. Unë do të ju tregoj, edhe të mitë kanë bartur qumësht. Unë kur kam filluar të studioj, në xhëp fletoren dhe shkoja

në fakultet. Kurse, nëna ime në autobusin e njejtë barte qumështin (të gjithë qeshin). E di unë i ri në pubertet si të më shohin duke bartur qumësht? Fshatar. Unë do të bëhem diçka tjetër. Dhe kështu... çfarë desha të them? Mua më tha babai im, “Prej nesër ti merri bocat dhe barte qumshtin. Nëna do të vijë nesër me ty dhe do t’i tregoj myshteritë, në cilën banesë dhe ku. Përndryshe largohu nga shtëpia. Nuk mund të shkoni edhe ti edhe nëna. Pasi që po shkon atje dërgoji edhe ato”. Dhe çka të bëjë, duhet! Do të më nxjerrë babai nga shtëpia. Për të mos më nxjerrë, atëherë jam frikësuar, po.

Dhe më kujtohet më dërgon atje nëna, më dërgon... e shoh unë një zonjë të bukur, unë i ri, në pubertet, sa i kam? 16-17 vjet, sa i kam pasur? Aq i kam pasur. Unë nesër menxi po pres të shkoj ta shoh atë zonjën e bukur (qesh). Po lexoj te dera Liljana Ivanoviq Çavolli. Unë vi dhe ajo e përgjumshme, e ka atë mantelin dhe pak i hapur e dini dhe unë po shikoj. Dhe kjo ka qenë Liljana Çavolli. Liljana Çavollin unë aty për herë të parë e kam takuar, unë dhe Liljana pastaj jemi bërë miq, unë jam marrë me muzikë unë kam kënduar ashtu edhe ajo. Unë e kam ftuar të këndoj në Çagllavicë, kemi qenë shok të mirë. Unë i kam treguar asaj se cila grua më ka pëlqyer për herë të parë. Kërkoj falje (qesh). Më thotë, “Kush?” I them, “Ti”.

Pjesa e Dytë

Momçillo Trajkoviq: Atë tregun e kam bërë unë, tregun në Prishtinë, në Ulpian, përballë postës së re, atë tregun e kam bërë unë. Pastaj, për një kohë e kanë thirrë “Momina”, si unë, “Tregu i Momës”. Unë e kam bërë atë si drejtor i “Ratar” në Llapla Sellë, atëherë kam qenë drejtor. Unë kam filluar... ne kemi investuar rreth një milion marka në atë treg dhe pastaj pas luftës ka ardhur mafia dhe na e ka marrë atë. Kjo është pronë e jona, ata na e kanë marrë tregun. Unë tani po mundohem ta kthej dhe tani qe 20 vite nuk mund ta kthejmë tregun. Ne, punëtorët e mi e kanë bërë atë. E kemi bërë atë lokalim, te zgat, nga kjo kemi jetuar. Sepse unë atëherë kur kam ardhur si drejtor ka qenë viti ‘94, kam marrë vendim që ky popull të mos mbjell vetëm grurë dhe misër, por kam dashur të shkojmë në atë intenzive... prodhimin intenziv, në perimtar. Ato fotografi duhet t’i gjejmë këtu, aty janë...

Për herë të parë në historinë e këtij fshati fillon... përndryshe ky vend është perimtar, por të gjithë... pak ka pasur perime. Çagllavica është marrë me prodhimin e perimeve në lumin Prishtevka atje poshtë, tani kur shkoni poshtë ku është rruga e re, ku është lumi. Ato kanë qenë kopshtet tona. Ne i kemi pasur kopshtet tona dhe me prodhimin e madh e kemi furnizuar Prishtinën. Në mënyrë që të ujiten, bëhet rrota dhe pastaj vjen kali dhe e rrotullon dhe uji del dhe ujitet domatja, speci, lakra etj, etj. Pra, Çagllavica njihet për këtë. Dhe kjo pjesë ka qenë afër lumit, kjo ka qenë toka jonë.

Dhe unë atëherë, kur jam bërë drejtor kam marrë vendim, pasi që kam disa miq tek Baçki Petrovac, që merren me perimtar, njerëz të Vojvodinës. Unë atje i kam parë ata dhe i kam lutur të vijnë për të na ndihmuar. Dhe këtu kanë ardhur sllovakët që jetonin atje. Ai Baçki Petrovac, ajo pjesa rreth Novi Sadit, atje jetojnë sllovakët. Pastaj, ata erdhën këtu zyrtarisht, kanë fjetur tek njerëzit tonë, kanë ardhur

special, kanë qenë bashkëpunues dhe kështu... kanë mbjellur specat, e gjithë kodra ka qenë e mbjellur me specat, domate dhe patate, 30 hektarë patate.

Pastaj ne, kur kemi filluar të merremi me bujqë... perimtari, atëherë kam kërkuar nga këta të komunës të më japin hapësirë, dhe ata ma kanë dhënë hapësirën ku e kemi bërë tregun dhe kemi shitur perime.

Kaltrina Krasniqi: Ju po flisni për tregun në Ulpianë?

Momçillo Trajkoviq: Po, për tregun në Ulpianë, ai është tregu ynë. Dhe po ju them atë e quajnë “Tregu i Momës”. E kanë thirrur për një kohë të gjatë. Pastaj pas luftës, unë këtë e kam kuptuar kur kam filluar të merrem me këtë, nuk e kam ditur çka është ajo. Unë shkoj atje, ata vijnë i blejnë tezgat, dhe përmuajshëm e paguajnë tezgën, në baza vjetore e paguajnë tezgën. Dhe kanë filluar të blejnë, diku po i grahin, kurse çmimet e specave, domateve ishin tepër të larta. Dhe kur kemi filluar ne të merremi me prodhimin. Kur unë mbushi, kur njerëzit e mi i mbushin traktorët, çdo mëngjes i mbushin traktorët me perime dhe shkojnë në treg. Dhe ne vendosim ç... për shembull ata shesin një euro, ne shesim 20 cent.

Dhe bie mafia dhe fillojnë të më kërcënojnë dhe unë i kundërvihem. Përndryshe, ai tregu i mafias shqiptare, sepse shqiptarët merren me atë shitblerje, në treg nuk ka pasur serbë atëherë, e as tani, nuk janë marrë me ato shit-blerjet. Dhe disa mafioz të rrezikshëm kur e kanë parë që unë nuk po e lëshoj kanë ardhur një ditë në zyrën time në Llaplla Sellë, në seli. Erdhën tek unë dhe thanë, “Sa kushton ta blejmë të gjithë prodhimtarinë?” Unë them, nënën... them, “Ejani nesër”. Që unë t’i llogarisë të gjitha. Dhe ata kanë blerë nga unë të gjithë prodhimin e vitit.

Erëmirë Krasniqi: Vetëm pak, a ka qenë ndërmarrje shoqërore?

Momçillo Trajkoviq: Ndërmarrje shoqërore ka qenë atëherë, po. E blenin të gjithë prodhimin. Të gjitha... ne nuk shkonim më në treg. Ata vinin dhe ngarkonin ne vetëm mblidhnim, ata merrnin. Kur atje i dërgonin ne paguanim taksën sepse tregu ishte i yni. Kështu e kemi bërë një bashkëpunim të mirë me ata. Përndryshe, atëherë... çmimet pak i kanë ulur. Pak i kanë balancuar çmimet, sepse kur ke monopol atëherë mund të bësh çfarë të duash. Dhe kështu ka qenë me atë tregun.

Kaltrina Krasniqi: Cilat vite kanë qenë këto?

Momçillo Trajkoviq: Ato janë ‘94-ta, 5, 6, 7, 8 deri në kohën e bombardimeve.

Kaltrina Krasniqi: Aha, të kthehem pak pas?

Momçillo Trajkoviq: Shkojmë.

Kaltrina Krasniqi: Ju keni ardhur në Prishtinë në vitin ‘83.

Momçillo Trajković: ‘83 kam ardhur në banesë në Prishtinë, në Dardani. Përndryshe deri atëherë...

Kaltrina Krasniqi: Si ishte Dardania në vitin ‘83?

Momçillo Trajković: Paj shikoni, ajo ka qenë, ajo ndërtesa ka qenë e re. Ndërtesa e re kurse në të kanë jetuar, serbët e vjetër të Prishtinës, qytetarët e vjetër turk dhe qytetarët e vjetër shqiptarë. Ata kanë pasur shtëpi ku tani është kinemaja, më herët ka qenë kinemaja Omladina [Rinia], a e dini ajo lagja tani ato ndërtesat. Dhe kur janë ndërtuar ato ndërtesat ata kanë, pasi që ato kanë qenë shtëpi të vjetra, ata kanë dhënë banesa qytetarëve, pronarëve të shtëpive dhe të gjithë kanë jetuar në atë ndërtesë. Të gjithë janë vendosur në atë ndërtesë. Vetëm unë dhe një gazetar, kemi qenë kështu anësor. Të gjithë të tjerët... ata thjesht të gjithë lagjen e kanë vendosur në atë ndërtesë, shqiptarët e vjetër, serbët e vjetër, turqit e vjetër. Kjo ka qenë shumë interesante.

Kur unë kam ardhur atje, pasi që ata janë mësuar të qëndrojnë para dyerve, para shtëpive dhe aty të flasin... atë mentalitetin dhe zakonet e kanë bartur edhe në ndërtesë. Ata aty vendosnin banka, pinin kafe, gjithçka (qesh)... ajo ndërtesa ka qenë ndryshe nga të gjitha. Dhe kështu njerëzit kanë qenë të afërm.

Pasi që unë kam qenë në pozitë të lartë, unë dhe një Stihović, unë them... dikush nga Novobërda, një shqiptar ka qenë drejtor i kësaj fidanishtes, Vitija, po. Më kujtohet, Vitija. Unë atëherë kam qenë funksioner, unë jam marrë me politikë, nuk e di sa e dini këtë... unë kam qenë sekretar ekzekutiv në Komitet, dhe e dini ajo kohë ka qenë se kush ka pasur pozitë të tillë të gjithë e respektonin, sidomos ata që kishin ndonjë pozitë.

Kaltrina Krasniqi: Kur keni filluar të punoni?

Momçillo Trajković: Në vitin ‘86, në vitin ‘86. Dhe vjen tek unë, “Çka mund të bëj për ju shoku Trajković?” Kështu ka qenë. Unë them, “Dëgjo, shko shiko dhe inçizo te ndërtesa ime dhe shikoj ata njerëz si jetojnë, e di ata njerëz janë shumë të mirë. Bëje, bëje mbjelli drunjtë”. Dhe ata drunj tani, nuk e di sa e dini, kur shkoni para tunelit poshtë tek ato ndërtesat. Të gjithë ata drunjt unë... ky ka qenë plani im, unë e kam kërkuar, për shkak të meje i kanë mbjellur. Këtë nuk e di askush, e dinë ata që kanë jetuar aty. Përndryshe të tjerët nuk e dinë. Kështu kjo është bërë, ai... mali thjesht para asaj ndërtese. Pastaj aty fare nuk ka pasur probleme, kudo që kanë mbjellur, vjen dikush dhe i shkul, kurse këta i kanë ruajtur, i kanë ujitur dhe drunjtë janë rritur. Sot ai është një park i paparë, është pjesë e Prishtinës që...

Pastaj unë, unë kam qenë pak aty në shtëpi sepse kam punuar, unë në vitin ‘86 kam hyrë në politikë në moshën 36 vjeçare, kam qenë sekretar ekzekutiv i Komitetit në Prishtinë, pastaj sekretar i Komitetit të Prishtinës, pastaj nënkryetar i Qeverisë Serbe. Pra, nënkryetar i Qeverisë së Serbisë. Kjo që është

Kosovë është e vogël, atëherë ka qenë Jugosllavia, ka qenë shtet i fuqishëm, nuk është si Kosova ose Serbia sot. Nënkrjetari i Jugosllavisë së madhe, asaj Jugosllavisë së madhe. Për shembull, ajo çka është Daçiq në Serbi për afërsisht kështu kam qenë unë.

Erëmirë Krasniqi: Si keni hyrë në politikë? Si ka qenë atëherë të jesh në politikë? Çfarë do të thotë kjo?

Momçillo Trajkoviç: Ka qenë një kohë vendimtare, ka qenë kohë e vështirë, kohë e pa mirëkuptimeve, koha kur shteti dhe institucionet nuk kanë pasur përgjigje për problemet e popullit.

Kaltrina Krasniqi: Kjo ka filluar në vitet '81?

Momçillo Trajkoviç: Kjo ka filluar në vitin '81 pas demonstratave të shqiptarëve në Prishtinë. Pasi që, sipas kushtetutës së vitit '74 Kosova ishte çdo gjë përveç shtetit. Shqiptarët kanë prirë, ka qenë përfërsisht si në kohën e komunizmit, siç është edhe tani. Vetëm se më herët, ajo që tani është Beograd jo Serbi por Jugosllavia, tani është Amerika. Atëherë kanë qenë komunistët, kurse tani janë nacionalistët dhe ballistët ja kështu. Përafërsisht kështu mund të them. Pra, vetëm ideologjia ka ndryshuar përndryshe çdo gjë është e njejtë.

Pasi që në Kosovë ka pasur më shumë shqiptarë ata kanë pasur çdo gjë në dorë. Dhe gjithmonë i kanë zgjedhur serbët e vet, sikur tani...tani edhe Vuçiq e ka hequr atë rastin dhe nuk po zgjedhin. Ata që kanë qenë të Thaçit serbët tani janë bërë të Vuçiqit. Kështu edhe në kohën e vet ka pasur më shumë serbë që i kanë shërbyer politikës shqiptare, shqiptarëve komunistë. Edhe nëse je imirë mund të shkosh nëse jo nuk mundesh. Kështu ka qenë. Më vonë Millosheviqi i ka pasur shqiptarët e vet. Kjo është ajo formula, kjo është ajo formula dhe kështu simulohen marrëdhënjet.

Dhe thuhet, "Paj shikoni vëllazërim-bashkimi". Kurse, vëllazërim- bashkimi ka qenë një simulim i madh, simulimi ka qenë te elita. Nuk ka pasur shumë simulime në popull. Në popull, populli nuk ka menduar shumë për vëllazërim-bashkim, populli ka menduar për marrëdhënjet fqinjësore. Shqiptarët dhe serbët gjithmonë kanë jetuar afër njëri-tjetrit, por kurrë kundër njëri-tjetrit. Kjo është. Edhe serbët edhe shqiptarët kurrë nuk kanë luftuar, as tani pas asaj çfarë ka ndodhur në vitin '99, serbët dhe shqiptarët nuk kanë luftuar. Kanë luftuar disa ushtri të çmendura. Pra, populli, vetëm populli ka pësuar. Populli është pasojë, viktim.

Erëmirë Krasniqi: Si ka qenë në Këshillin Ekzekutiv kur kishte edhe shqiptarë?

Momçillo Trajkoviç: Atëherë shqiptarët kanë sunduar, kjo ka qenë, kjo ka qenë, unë kam shkuar atje në vitin '86. Atëherë ka qenë Mahmut Bakalli, Fadil Hoxha, atje lart në Beogradit, pra të gjithën, ata e kanë mbajtur. Ata ishin komunistë kurse tani i kanë serbët frikacakë rreth vetes dhe tani po luajnë rolin e vëllazërim-bashkimit. Kurse paraqesin... kjo ka qenë politika e Titos, ai ka pasur qëllimin më të mirë që ajo të ishte. Por, e dini nga burimi uji është i kthjelltë dhe kjo pastaj ka kushtuar...

Pas '70 dhe... vitit '68, pas vitit '74, kur Kosova e ka fituar kushtetutën. Kur është krijuar çdo gjë dhe jo kush është krijuar, por nuk është shtet. Nuk është republikë por autonomi, sikur të jetë shtet, ata bëjnë demonstrata në vitin '81. Dhe serbët edhe ashtu, serb ka, serbët kanë menduar se pasi është Serbi, ata duhej të ishin, ata janë serbë dhe ata duhet të ishin, ata duhej të pyeteshin, apo jo. Por kjo ka qenë diku deri në vitin '66, pas rënies së Rankoviçit po vjen një kohë tjetër. Ata të cilët Rankoviçi ka dashur t'i mbyll vijnë në plan të parë dhe fillon, atëherë fillon balansi.

Krjimi i opsionit komunist. Përndryshe malazezët, serbët, pra Tito po shkon, Tito nuk është as serb as malazez, por tempo, Dushan Mugosha, Milladin Popoviç. Ata e kanë krijuar partinë komuniste të Shqipërisë, a e dini. Mugosha, Popoviç dhe Milladin Popoviç dhe një numër i komunistëve serb, ata kanë krijuar, janë përcaktuar për komunistë shqiptarë. Kush do të jetë partner i tyre, ai ka qenë Fadil Hoxha, Xhavit Nimani, Mahmut Bakalli. Mahmut Bakalli, më vonë, Veli Deva, ky ishte grupi i vjetër.

Në këtë grup ka qenë ky Boro Vukomiroviç dhe Ramizi. Ata, ata janë vrarë. A e dini se si ka qenë. E gjithë kjo ka qenë deri në vitin '66 pas vitit '66 pasi që sikur sot i kanë marrë pozitat në vitin '45 ata që kanë qenë nëpër male. Partizanët. Ata që kanë qenë në male, ata kanë ardhur në pushtet. Njëjtë sikur tani UÇK, njëjtë por vetëm po them ideologjitë kanë ndryshuar. Këta që kanë qenë në male, nuk është e rëndësishme sa dinë e rëndësishme është që ke qenë atje apo nuk ke qenë. Apo a dëshiron dikush të vërtetoj apo të gënjejë për ty se a ke qenë atje apo jo.

Erëmirë Krasniqi: Ku keni qenë ju në vitin '81?

Momçillo Trajkoviç: Në vitin '81 unë kam punuar në Këshillin Ekzekutiv të Kosovës. Mua më kujtohet, më kujtohet si jo. Unë do të ju tregoj për këtë. Kjo ndihet, unë kam punuar në Këshillin Ekzekutiv të Kosovës, e kam pasur një mik, nuk dua ta përmend ka qenë shqiptar, mik i madh i imi {vendos dorën në zemër}. Nuk e di nga, flas sepse nuk kam, nuk e di, çka mund të ndodh me këtë, përveç nëse përdoret me qëllim të mirë. Por nuk dua ta përfshij atë këtu.

Ne kemi punuar bashkë, në të njëjtën zyre. Së pari, menxi më kanë pranuar, ka qenë shumë e vështirë të punësosh si serb, shumë e vështirë. Unë kam konkuruar në atë sekretariat për punë në Kosovë, në vendin e punës bashkëpunor profesional, jurist. E kam dërguar këtë dokument dhe ushtrinë nuk e kam përfunduar dhe para ushtrisë më vjen mua përgjigja, pasi që unë i vetmi kam konkuruar, thotë, "Nuk mundet, jeni refuzuar, kërkesa juaj është refuzuar sepse nuk keni konkurrencë". Mund ta paramendoni pasi që nuk kam pasur konkurrencë ata më refuzuan, unë dorëzoj ankesë dhe i dëshpëruar shkoj në ushtri.

Ka qenë viti '77, diku në prill, qershor, jo, jo, në qershor kam shkuar në luftë kjo ka ndodhur në maj. Unë kthehem nga ushtria në prill të vitit '77-'78, më 28 prill, kurse para kësaj mua më thërret gruaja dhe më thotë, "Të ka mbërritur aktvendimi, po të thërrasin të shkosh në punë". Kërkesa ime është

shqyrtuar një vit, unë kam qenë në ushtri dhe kur jam kthyer nga ushtria menjëherë kam shkuar në punë. Kur atje kam mbërritur, të njejtën ditë me mua është punësuar edhe shoku im, nga Rugova, nga Peja, i juaji. Dhe ne aty po rrinim ulur, punonim, shoqëroheshim, ai është pak më i moshuar se unë, ai është katër vite më i madh se unë, por kemi qenë të rinj, unë atëherë i kam pasur 28 vjet.

Dhe mua, tani vijnë tek unë disa informata për të, thonë, që ka qenë pjesë e demonstratave të viteve '68, atëherë ka qenë ashtu që nëse ke qenë pjesë e demonstratave të viteve '68 të janë mbyllur të gjitha dyert. Por, ai ka ardhur nga Peja dhe aty është punësuar dhe ka hyrë brenda. Dhe asgjë, unë e marr vesh këtë dhe tani ne po rrimë ulur dhe po bisedojmë unë e di, ai nuk e dinë që unë e di dhe kështu me rradhë (qesh). Por, unë e kam parë si person të drejtë shqiptar. Kurrë nuk do ta harroj kur (qesh) së shpejti kur jemi parë dhe gjithnjë flas sa ka pasur sens për humor.

Quditërisht ka, tregime popullore, legjenda, anekdota shqiptare, është e jashtëzakonshme. Nesrit kur e mendon, pak e shihni se ku jeni (qesh). Ai më thotë mua, shiko, më besoni, nuk e di në çka të betohem. Në vitin 1978 ai mua më thotë derisa ishim duke ngrënë mëngjes, derisa kemi qenë ulur dhe popinim kafe më thotë, "Momo ta tregoj një barcoletë". "Hajt", Selim quhet, "Hajt Selim fol". Thotë, "Po flasin dy shqiptarë në vitin 2000..." Për besë (qesh) kështu më ka thënë njeriu, në vitin '78 ma ka thënë këtë. "Hej", thotë fqinji, "Eja", thotë, "të pijmë çaj". Ky tjetri thotë, "Kisha ardh por po e pres një serb të më i sharrisë drunjte" (qesh dhe duartroket).

Nga ajo koha serbët nuk sharrisin drunjte por sa ka ndryshuar situata, sa ka ndryshuar, këtë ma ka thënë edhe një herë ma ka thënë, dhe gjithnjë kur bie shi më kujtohet ai. Thotë, "Bre, gjithë atë kokë e ke, gjithmonë kur kalon kah rryma nuk ke si të mos ja huqësh". Shiu duhet të bie mbi kokë dhe gjithmonë kur më kujtohet ai unë them, "Selo, ke pasur të drejtë". Por megjithatë, kurrë askujt si kam thënë, sepse, edhe unë jam i ngjashëm me të. Edhe unë jam njeri mendjehapur, kam një qëndrim, e dua popullin tim, i dua, nuk i urrej të tjerët, i dua dhe i respektoj. Kam mjaft miq dhe e kam parë që është i njejtë si unë.

Dhe ulem pastaj si sekretar i i organizatës themelore të Lidhjes Komuniste, dhe unë e bëj, nuk e di, diçka kam thënë, e dini si ka qenë atëherë. Sepse presin në një kënd se çfarë do të thuash (qesh), menjëherë, menjëherë, takimi i partisë. Unë, edhe tani po them eja Selim ta caktosh. I pari Selimi nuk dëshiron ta caktoj takimin. "Çfarë takimi, çka për Momën, ikni bre", thotë. Pastaj një ditë është dashur të mbahet takimi. Dhe filluan ata të më sulmonin... Dhe kur u qua Selimi (qesh), thotë, "Si nuk keni turp, si është e mundur? Unë jam me Momon çdo ditë. Këtë që po më tregoni nuk është e saktë".

Dhe kështu, unë dhe Selimi bëhemi...Babai im shumë e ka dashur Selimin,, ne kemi shkuar tek ai, jashtëzakonisht e ka dashur, të mos them si mua. Sigurisht mua më ka dashur më shumë se Selimin por ja, Selimi sot po them shumë e ka dashur Selimin. Sepse Selimi është një rugovian i vërtetë. Shqiptar i vërtetë, (serioz) ai shqiptar i vërtetë, i cili, për respekt. Jo shqiptari kështu, por, shqiptar për respekt. Pra, është një karakter, një integritet moral, i hapur dhe me respekt, kjo është ajo.

Dhe, edhe unë jam shqiptar, unë populli im kështu, populli im, ne gjithmonë flasim për këtë dhe gjithmonë me një njeri të tillë shumë më mirë mund të flasësh se me ata që paraqiten me vëllazërim-bashkim, dhe kështu, e kështu. Dhe pastaj, kur unë bëhem nënkryetar i Qeverisë, unë filloj ta tregoj një tregim timin dhe Selimit, Selimit kjo nuk i pëlqen. Ai hidhërohet me mua. Por, tani do të ju tregoj edhe diçka. është shumë interesante, Unë deri tani, vetëm që sonte të mos qaj, do të mundohem të mos qaj. Unë bëhem nënkryetar i Qeverisë Serbe...

Erëmirë Krasniqi: Cili vit ka qenë?

Momçillo Trajković: Ka qenë viti '90. Atëherë pasi që shqiptarët e lëshonin punën, kështu policia lëshonte, shqiptarët lëshonin, Serbia merr vendim ta suspendoj autonominë dhe unë jam në krye të asaj politike. Pra, unë jam në krye të politikës në vitin '90 kur Serbia merr vendim që autonomia të suspendohet. Dhe unë vi në kabinetin tim në Beograd. Atëherë merret vendimi që kabineti im të jetë edhe në Beograd edhe në Prishtinë. Unë me Jusuf Zejnullahun kam qenë mik i mirë.

Jusuf Zejnullahu është shqiptari i fundit që ka qenë me Millosheviqin. A keni dëgjuar për Jusuf Zejnullahun? Ka qenë Kryetar i Qeverisë atëherë. Ai është shqiptar i fundit i cili në një mënyrë, kur mua Millosheviqi më ka thirrur të më bëjë nënkryetar të Qeverisë unë i kam thënë, “Ky do të jetë fundi ynë final me shqiptarët”. Sepse një milion e gjysmë shqiptar, Serbia nuk e ka askënd që do ta përkrah politikën e saj dhe ta vendos serbin. Kjo do të thotë fund. I them, për këtë arsye ne nuk, ne nuk do të themi, “Ja ku e keni republikën”. I themi Millosheviqit.

Unë jam ulur me Millosheviqin sikur kështu me juve, një vit kemi qenë shumë të afërt. Deri sa nuk jemi fjalosur. Unë pastaj kam pasur një konflikt me të dhe pastaj jam bërë drejtor i korporatës. Nga nënkryetar i shtetit jam bërë drejtor i korporatës. Dhe po vij unë në Prishtinë që situata të qetësohet, të shohim çka ka më tutje, por jo shqiptarët nuk po pranojnë {lëviz dorën} këtë politikë të Millosheviqit dhe largohen dhe i kundërvihen në fillim. Dhe unë tani po vij në Prishtinë.

Kabineti im është në të dytin, në katin e dytë, ato ndërtesat {tregon me dorë} ku është tani parlamenti. Tani është qevria në atë ndërtesën e madhe por më herët ka qenë atje. Dhe po pyesin se si është gjendja, vij, si është gjendja në ndërtesë së pari, aty ku janë shërbimet, ku janë ministritë, si është gjendja. Dhe çdo ditë nga shërbimi unë marr raport. Pasi që unë jam nënkryetar i qeverisë, ky është njeri i fuqishëm. Policija, çdo gjë nën kompetencën time unë mbaj çdo gjë. Dhe vij një ditë, marr raportin, si është çdo gjë në ndërtesë, “Gjithçka është OK?” Thotë, “Vetëm është një, një problem i vërtetë”. “Kush po bën problem?” “Njëfarë Selim Nikqi” {duartroket}.

Po thotë, duan ta [largojnë], unë them, “Nuk guxonin ta prekni. Unë do të flas me të”. Dhe asgjë, pastaj unë i them sekretarëshës sime, kurse Selimi atje në zyre (flet me emocion, lëviz duart) ku kemi punuar unë dhe ai, po (qesh). I them unë Selimit, jo, sekretarëshës, “Ma jepni, ma thirrni Selimin”. Ajo e thërret

Selimin, ky po thotë, “Nuk do të vij”. Mirë. Po thotë nuk dëshiron të vij, ai është aty, aty në shërbimin për punë, siguria shtetërore, kështu-ashtu. Them, “Jo, lëreni unë do të shkoj atje”. Dhe unë ngrihem, shih (qesh). Shkoj atje, në zyre ku kemi punuar të dy bashkë për aq shumë vite (qesh).

Ai i ka mbledhur shqiptarët, ata që punojnë {lëviz dorën në rreth} aty, njëfarë, Heset Mazrekaj, i cili ka qenë, çka ka qenë, ka qenë avokat shtetëror, Heset Mazrekaj. Ai është Shema Uka një avokat i vogël, një i vogël, deri tek mjekra të vjen {tregon gjatësinë me dorë}. Selimi thotë kur ky Shema hyn, a Selimi dhe unë e kemi punësuar aty, thotë kur Shema hyn, ai e hap derën {lëviz dorën përnjëherë} sikur do të hyj ndonjë njeri i madh (qesh) por, thotë, “Shiko çfarë je?” Thotë, “Deri te doreza e hap derën” (qesh). Dhe hyj unë, “Mirëdita”. Ata heshtin.

“Ne ty nuk të pranojmë, nuk dëshirojmë kontakt” {lëviz dorën}. “Nuk e pranojmë politikën serbe”. Unë e hap derën, një hap pas dhe them, “*Pu pu pu* {onomatope}, unë nuk jam nënkryetar, ja nuk jam nënkryetar, unë këtu kam ardhur si miku juaj Moma Trajkoviç”. Ulemi dhe flasim, unë ju them atyre, “Shikoni çfarë kohe ka ardhur, këto janë vendime të mëdha, ju nuk mund ta ndaloni këtë. Bëne punën tuaj, këtu jam unë”. Pasi që ne kemi punuar bashkë. “Unë do të mbroj sa mundem. Ju bëne punën tuaj, ejani në punë, shkoni”.

Okej, aty pak jemi marrë vesh, unë shkoj, për shkak, secili, çdo të ejte sanca e qeverisë në Beograd. Unë duhet të shkoj të enjteve atje... vij prapë, dhe në tavolinë raporti, kush po bën problem? Selim Nikçi (qesh). Unë them, “Mos e prekni. Mos {lëviz dorën} e prekni”. Prapë shkoj në shtëpi, kur kam ardhur herën e tretë, e marr raportin se Selim Nikçi {lëviz dorën} është ëprzënë në shtëpi. Sepse e dini, ju mund të jeni edhe nënkryetar dhe kryetar por shërbimet që i kanë vlerësimet, e dini, ata nuk presin që politikanët të reagojnë, por reagojnë ata.

Për shkak të mbrojtjes thjesht ata reagojnë dhe Selimi është në shtëpi. {frymon thellë} Eh nëna ime dashur, e çka është, si për dy vëllezër, dy vëllezër dhe tani unë jam ekzekutuesi i Selimit. Jo unë personalisht, por politika {tregon kah vetja}. Cili unë që... e thërras unë Selimin të shihemi. E ka një stojadin² të vjetër, unë me veturë zyrtare deri diku, prej diku i them unë do të dal në këmbë dhe flasim në veturën tënde. Dhe aty pikërisht para ndërtesës, ai banonte aty ku banoja unë, ndalemi. Unë dal nga vetura, vazhdoj në këmbë dhe shkoj të mos më shohin, e di, ulem në veturën e tij dhe po rrinim ulur, fillojmë të flasim.

“A je bre ti normal?” I them unë atij. “Gruaja jote e ka lënë punën”, apo e kanë përzënë, nuk kam ide se çka ka ndodhur. “Ti e ke lënë punën {numëron me gishta shembujt}, si do të jetosh?” “Unë nuk dua të jem tradhtar i popullit tim”. Kështu më thotë Selimi. “Kush more tradhtar i popullit, shko dhe eja nesër në punë. Unë jam aty. Ulu aty, rri disa ditë, shko. Nëse dikush të pyet unë të kam lënë”. dhe largohem.

² Stojadin, nofkë e veturës së popullarizuar *Zastava 101*. Prodhues i makinave me lokacion në Kragujevc, Serbi, bëri makina me bazë Fiat për tregun e Evropës Lindore. Kompania u bë një degë e *Fiat Chrysler Automobiles* në vitin 2014.

Asgjë, fillojmë e qajmë, unëdhe ai qajmë, unë po të them (qesh) vetëm të qajmë si dy shokë. Ne jemi shok, shok të shtëpisë. Babai im e do atë si mua, e kupton. Atëherë babai më kishte vdekur, babai më ka vdekur në vitin '86, dy muaj para se të hyja në politikë, mua më ka vdekur babai.

Dhe babai im, që aq ka pasur dëshirë që i biri i tij të ketë sukses, i shkreti nuk ka arritur të sheh se çka jam bërë, si dhe...unë kam menduar që Selimi do të vjen. Kurrë ai qen {tregon me gisht} kështu nën shenjën “qen” nuk ka ardhur. Kaq ishte, dhe më vonë kur ecja rrugës unë nga njëra anë, e kur ai më sheh as nuk dëshiron të flas me mua. Gjatë kohës së luftës, Pasi që unë të shumtëve ju kam ndihmuar, këtë e dinë, tani të mos flas por gjatë luftës të shumtëve, fillimisht në ndërtesën time ju kam ndihmuar... por unë atëherë kam qenë kundërshtar i Millosheviqit, unë kam qenë kundërshtar i Millosheviqit. Unë jam larguar nga Millosheviqi në vitin '91.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë ka ndodhur?

Momçillo Trajković: Paj, jemi fjalosur, rreth Kosovës. Unë nuk jam pajtuar me proceset demokratike atje në Serbi. Unë kam qenë njeri i fuqishëm, pra, nuk jam pajtuar. Përndryshe do të isha president Jugosllavisë, unë kam qenë afër, i gatshëm për president. Në librin tim {tregon drejtimin} janë ato, stenografët ku unë jam nominuar të jem antar i zyrës përfaqësuese të Jugosllavisë. Edhe Liliq kur ka qenë president i Jugosllavisë, në fakt unë është dashur të bëhem president i Jugosllavisë.

Unë e kam lënë Millosheviqin, i kam thënë atij, “Dëgjo, po shkoj të ha bar në Çagllavicë. Babai m’i ka lënë katër hektarë tokë”. Dhe e kam lënë e kurrë më se kam parë. Atëherë jam bërë drejtor i kooperativës, të gjithë janë çuditur a është e mundur. Dhe atëherë pasi nuk kemi pasur nga çka të je, unë e kam hapur një kioskë në qendër të Prishtinës. Përballë Grandit, ndër Avallë. Aty e kam pasur kioskën ku unë kam punuar në atë kioskë. Dhe puna, gjithë natën ka punuar kioska.

[Intervista është ndërprerë për shkak të problemeve teknike]

Erëmirë Krasniqi: Do të thotë e keni hapur kioskën ku?

Momçillo Trajković: Po, Avalla. Aty është një, ku është KEK-u tani, aty poshtë, {tregon me dorë poshtë} poshtë. Ku është ajo platoja, aty por aty e kemi pasur deri pas '99 deri në muajin qershor, kur na e kan hequr, na e kan marrë, i kanë vjedhur të gjitha ato. Dhe kaq kam, por mirë, atëherë unë në kohë të luftës i kam ndihmuar të shumtëve.

Erëmirë Krasniqi: Mos shkoni te lufta, vetëm pak të flasim për këtë, Ju keni qenë, si thuhet, keni qenë në pozitë.

Momçillo Trajković: Po.

Erëmirë Krasniqi: Funkzioner i rëndësishëm. Si ka qenë për juve, si ka qenë atmosfera kur ka ndryshuar çdo gjë? Në fillim keni thënë, ka qenë shtet komunist...

Momçillo Trajkoviq: Po prej komunizmit, prej, prej shqiptaro nacionaliste komuniste, ka ardhur deri te politika nacionaliste serbe, pastaj ka ardhur Millosheviqi. Atëherë ka ardhur Millosheviqi.

Erëmirë Krasniqi: Si jeni ndjerë kur shokët tuaj janë larguar nga puna apo janë?

Momçillo Trajkoviq: Unë jam dëshmitar i asaj. Në fillim shqiptarët, që t'i kundërviheshin politikës së Millosheviqit, e linin punën. Policia, askush nuk e ka detyruar policinë, policinë kosovare atëherë. Ata e lëshonin policinë. Duke demonstruar kundër politikës. Por, më vonë unë jam fjalosur më Millosheviqin. Ne, për shembull, unë kam ardhur deri te një konflikt i madh me Millosheviqin dhe njëfarë Kecmani, i cili diku në qershor, jo në qershor por në shtator, unë mendoj më tre shtator kur ka qenë greva gjenerale e shqiptarëve. I ka mbyllur, i'a ka vënë drynin dyqaneve.

Shqiptarët, bënë grevë, ky vendoste dry e dini, {tregon me dorë} unë atëherë për herë të parë kam kundërshtuar ashpër. I kam thënë, "Nuk bën". Dhe më kujtohet, kam dhënë deklarat, në Tanjug kam dhënë deklarat, ashpër e kam, ashtu, kritikuar. Atëherë kanë ardhur, pas meje kanë ardhur, ata, ata që deri dje kanë qenë me komunistët shqiptar. Për shembull, njëfarë Papoviq, rektor Papoviqi, ai, është i biri i dervishit të Rozhajës. Dervishi e ka bërë edhe profesor edhe komunist. Që ai të jetë njëri prej kundërshtarëve më të ashpër kundër shqiptarëve. Pas kësaj unë kam shkuar pastaj ka filluar, pastaj ka ardhur deri te dëbimi, si jo.

Pastaj, atëherë ka, ka filluar. Dhe ka ardhur, njerëzit janë dëbuar nga puna.

Erëmirë Krasniqi: Do të thotë ju keni qenë të pranishëm në dy momente shumë të rëndësishme të '81. E ju keni qenë shumë i ri.

Momçillo Trajkoviq: Po, atëherë kam qenë, unë atëherë e kam fituar sheqerin. Ja për shembull, që atëherë sheqerin, shtypjen, kërkoj ndjesë. Prej atëherë e kam shtypjen, këtë nuk do ta harroj kurrë.

Erëmirë Krasniqi: A ju kujtohet ajo ditë?

Momçillo Trajkoviq: Si nuk më kujtohet, unë dhe Selimi kemi shkuar. Na jepin neve detyrë, na jepin për detyrë të shkojmë t'i qetësojmë studentët, t'i ndalojmë. Po, bash ka qenë, po. Partia e cakton detyrën, dhe unë e Selimi nisemi për atje. Dhe kur kemi ardhur te ajo masa, Selimi më lut mua dhe më thotë, "Të lutem, mos e fol asnjë fjalë serbe". Ka qenë viti '81 "Mos fol në gjuhë serbe" e di. Dhe me të vërtetë unë kam heshtur, e shoh, dikush që i duhet patjetër, askush, askush nuk ka qenë i sinqert që ta kthej. As nuk ka mundur të të kthej. Të shkosh ti dhe t'i bindësh njerëzit të cilët tashmë janë drejtuar për një gjë të tillë.

Dhe kjo ka qenë, ka qenë një, një situatë mjaft konfuze. Atëherë shqiptarët mundohen ta arsyetojnë këtë, që këtë e ka organizuar sigurimi shtetëror serb. Mendoj që ajo nuk ka lidhje. Së pari, në atë kohë komunistët serb, komunistët prijës dhe komunistët shqiptarë kanë qenë vëllezër. Dhe Tito, ka qenë jugosllave, nuk ka qenë politikë serbe. Atëherë ka qenë politika jugosllave. Demonstratat e vitit '81 nuk e kanë qetësuar Beogradin, përkatësisht Serbinë. Atëherë as që ka ekzistuar Millosheviqi. Por policia federale i ka bërë këto.

Stane Dolanc edhe në Hajvali ka qenë e madhe, kazerma e madhe e policisë federale të cilën e ka. Edhe sllovenët edhe kroatët nga të gjitha republikat dhe krahinat kanë qenë aty për ta ndaluar. Por duke arsyetuar këtë, shpesh do të gjeni atë justifikim që këtë e ka bërë sigurimi shtetëror serb. Mendoj që kjo nuk është e saktë, nuk është e saktë që sigurimi shtetëror serb nuk ka qenë kështu dhe nuk ka qenë kryesorja. Kryesori ka qenë sigurimi shtetëror federal, që ka mbajtur gjithçka nën kontroll. Dhe kjo ka qenë, ka paditur pasi që ka qenë menjëherë pas Titos. Pas vdekjes së Titos, taman është kjo, kjo disi...

Erëmirë Krasniqi: Dhe pastaj ju keni pasur për detyrë të flisni me studentët?

Momçillo Trajković: Po, detyrë që të shkojmë, të dalim atje. Po, prandaj Selimi më tha, “Mos fol, mos fol serbisht, të flasësh serbisht”. Por, por është do të thotë pafuqia e shtetit, pafuqia e institucioneve. Nëse ju bini në to, përfundoi. Institucionet nuk kanë funksionuar, unë do të ju them edhe, për shembull, problemi ka qenë tek sistemi, sistemi ka qenë, sistemi i separatizmit në Jugosllavi, pra edhe separatizmi shqiptar, edhe slloven dhe kroat ka qenë në institucione. Kushtetuta, Kushtetuta në vitin '74 i ka definuar marrëdhënjet e tilla, kurse Kushtetuta nuk është kryer deri në fund në mënyrë që të parandalonte. Pra, kush është fajtor, fajtor është Kushtetuta e vitit '74 dhe mos kryerja e saj, se nëse ajo Kushtetutë do të bëhej si duhet, nuk do të vinte deri te ajo. Dhe pra, institucionet nuk kanë funksionuar, pastaj kanë filluar të përballen me popullin, me njerëz të mashtruar.

Mua më kujtohet nëse fëmija shkruante “KR” në bankë, fëmija shqiptar, nxënës, e shkruan “KR” në bankë, menjëherë e gjithë familja izolohet. Unë atëherë kam hyrë, e kam diskutimin lidhur me këtë, “Me tradicionalizëm kundër separatizmit”. Për çka bëhet fjalë, në fakt ti në këtë mënyrë e çliron, e zgjeron atë lëvizje. Duhet të ekzistojnë institucionet, të shohim se për çka bëhet fjalë. Pra kjo është, është ajo, ai ka qenë edhe problemi. Dhe kjo është, kjo është, të jemi të sinqert, duhet të jemi të sinqert aty. Unë tash shpejt kam folur me Azem Vllasin, dhe ai tani atëherë e thotë këtë, tani e thotë këtë.

Që shqiptarët komunistë kurrë nuk kanë qenë të sinqert në krijimin e Jugosllavisë. Shqiptarët komunistë në çdo timin, madje edhe shqiptarët komunistë, kanë pasur për detyrë të bëjnë këtë që është sot. Ndoshta jo në mënyrën si ka ndodhur por të krijojnë diçka. Qëllimi ka qenë Republika e Kosovës, kurse nga Fadili e deri te Azemi kanë qenë, ata kanë qenë shumë kundër kësaj, kinse shumë

kundër, në fakt kur çdo gjë ka kaluar, të gjithë janë mburr që kanë marrë pjesë në krijimin e politikës së tillë.

Pra nuk, nuk ka pasur marrëdhënje të sinqerta brenda asaj. Kjo i ka dhënë shansin nacionalistëve serbomadh të thonë, “E shihni se për çka bëhet fjalë këtu?” Dhe ata nacionalizmin serbomadh e përdorin si kundërpërgjigje për separatizëm, e që asnjëra nuk është zgjidhje. Ky ka qenë, ky ka qenë ai problemi. Tani, sepse ajo, lidhja e Prizrenit, ajo është vendosur. Sikurse të gjitha, të gjitha kombëtare, të gjitha lëvizjet kombëtare i kanë caqet e veta. Kështu edhe lëvizja kombëtare shqiptare e ka pasur qëllimin e saj.

Politika, Tito ka arritur që ta, Tito ka arritur që ta “amortizoj”. Por Tito nuk ka pasur sistem, sistemi i Titos ka qenë ai. Në momentin kur ai është zhdukur, janë zhdukur edhe, është zhdukur edhe sistemi, janë zhdukur institucionet, dhe pastaj është dashur që gjithçka të shpërbëhet në masë të madhe. Por fatkeqsisht, është shpërbërë me gjak. Ajo që ka ndodhur në Bosnje, ajo që ka ndodhur në Kroaci, ajo që ka ndodhur në Kosovë, është një tragjedi e madhe.

Erëmirë Krasniqi: Fëmijët tuaj kanë shkuar në shkollën Dardania?

Momçillo Trajković: Po.

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë ajo shkollë e ndarë në dy...

Momçillo Trajković: Më herët kur kanë shkuar ata, ka qenë edhe më vonë është ndarë.

Erëmirë Krasniqi: Po.

Momçillo Trajković: Më vonë është ndarë, por më vonë në fillim kanë qenë bashkë. Bashkë, kurrë nuk kanë qenë bashkë, por ka pasur, ka pasur një lloj tolerance. Unë në një, unë për herë të parë jam takuar me shqiptarët kur kam shkuar në shkollë të mesme, në shkollën e mesme. Atëherë për herë të parë, deri atëherë unë, unë kam jetuar në Çagllavicë, aty kurrë nuk kanë jetuar shqiptarët. Dhe ky ka qenë problemi im i madh, prandaj unë nuk e kam mësuar gjuhën shqipe, dhe jetoj këtu. Pra kur kam, atëherë kur kam shkuar unë në shkollën e mesme, atëherë shqiptarët mësonin në gjuhën shqipe, por kemi pasur trajnimin para ushtarak, ata kanë, bashkë kemi mësuar në gjuhën serbe. Unë nuk e kam pasur për obligim ta di gjuhën shqipe. Shqiptarët të paktën në atë trajnimin para ushtarak ose kur kanë shkuar në ushtri, e dini, kur shkonin në ushtri e mësonin gjuhën. Unë si serb nuk e kam pasur ndonjë përgjegjësi.

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë kjo e çuditshme për juve?

Momçillo Trajković: Paj nuk ka qenë e çuditshme, nuk ka qenë e çuditshme. Është Jugosllavia, Serbia dhe kaq, kështu unë, kështu unë e kam paramenduar këtë, e di. Pastaj me shqiptarët më seriozisht jam takuar në fakultet. Gjatë viteve të '70-ta or në kohën kur gjuha ka qenë mjet për llogaridhënje në mes njëri-tjetrit. Atëherë ka filluar që shqiptarët të mësonin gjuhën serbe kurse serbët të mos e mësojnë gjuhën shqipe. Atëherë ka pasur, ka pasur ndarje, demonstratat e famshme në Fakultetin Juridik, unë kam qenë aty në vitin '71. E dini...

Pra gjuha ka qenë mjet për llogaridhënje. Dhe pastaj, ashtu i padobishëm, të komunikosh me gjuhë ti shkon në institucione të cilat, po gjuha serbe respektohet në sistem, respektohet. E dini ka përkthim andej-këndej por ai që e flet gjuhën shqipe, që e dinë dygjuhësinë. Shqiptarët e dinin edhe njërin edhe tjetrin, ata kanë shpërblime, nuk e di fiton në rrogë, i rritet. Por serbi që i flet dy gjuhët, edhe atij, por më pak serbë e flisnin gjuhën shqipe, kurse më shumë shqiptarë kanë qenë që e dinin gjuhën shqipe dhe serbe.

Erëmirë Krasniqi: Pse mendoni që ka qenë kështu?

Momçillo Trajković: Si?

Erëmirë Krasniqi: Për atë arsye, për shembull, shqiptarët kryesisht e kanë mësuar gjuhën serbe, edhe pse kanë pasur shkolla në gjuhën shqipe...

Momçillo Trajković: Paj kanë qenë, kanë qenë në sistemin e Jugosllavisë dhe Serbisë. Ata kanë qenë, ata janë ende. Ata gjatë gjithë kohës kanë qenë, që nga Mbretëria Jugosllave kanë qenë të drejtuar kah gjuha serbe. Serbët nuk kanë qenë të drejtuar në atë, sidomos serbët të cilët, sikur ne. Unë, unë kam, tani do të ju flas për atë, ju lutem, të kthehem tek Rahoveci, të ju tregoj, kjo është shumë e rëndësishme për këtë vend dhe për Çagllavicën. Të shihni se çfarë shoqërie ka qenë.

Dhe sikur të jetë, pra trajnimi para ushtarak, do të thotë ajo është, ato janë orë për përgaditjen për ushtri, për para ushtri. Do të thotë të gjithë ne bëhemi gati por gjithçka në gjuhën serbe, nuk ka pasur, atë atë, kështu ka qenë, ka qenë progres. Pra unë me shqiptarët jam takuar në trajnimet para ushtarake, bashkë në klasë kemi qenë shqiptarë dhe serbë si dhe ai oficeri që na mbante ligjeratë për armë, për ushtri, e të tjera. Kur të shkojmë në ushtri, në ushtri, atje flitet gjuha serbe, përkatësisht gjuha kroate, gjegjësisht tani gjuha malazeze dhe kështu me radhë. Gjuha sllovene dhe kështu me radhë.

Pra, shqiptarët dhe të gjithë që ishin jo-slloven, ata është dashur ta mësojnë për të komunikuar në shtetin slloven, me institucionet. Edhe pse kanë mundur në lokal të komunikojnë në gjuhën e vet dhe pra kjo ka qenë, ky ka qenë tani më problem. Dhe...

Erëmirë Krasniqi: E më tregoni, si ka qenë atmosfera gjatë '80-tave? A ka ndryshuar atmosfera pas demonstratave të vitit '81?

Momçillo Trajkoviç: E prej atëherë. Pastaj, pastaj fillon, ato janë beteja të simuluar kundër separatizmit shqiptar. Është viti '81, lëvizja separatiste është treguar, në këtë mënyrë, këto kanë qenë vlerësimet politike. E dini, çka është tash, të tjerët ndryshe, unë tani po flas nga ai aspekti, unë sot mund të flas edhe ndryshe për këtë, por si është shikuar kjo në atë kohë.

Ajo është lëvizja separatiste që ka dashur ta shfrytëzoi vdekjen e Titos, ta shtyjë këtë, të kërkojë republikë dhe kështu me radhë, e kështu me radhë. Dhe tani, lëvizja komuniste, Komiteti Qendror diskutojnë, por askush nuk hyn në thellësi të problemit, e dini. Për atë që fola më herët, pra simulojnë atë betejën, por nga ana tjetër atë, atë nacionalizmin sa është i varur, që kur flitet se sa i pabarabartë është, si mund ta dish, që e fiton masën. Pasi që ka qenë e pa suksesshme beteja e komunistëve, në atë kohë, jugosllaven, serb, kroat, dhe atyre shqiptarëve këtu kundër separatizmit, pastaj te populli serb fillojnë pakënaqësitë.

Pra ata që kanë qenë në vitin '81 një numër i njerëzve është gjykuar, situata është e tillë, ata që kanë krijuar gjithë këtë ende ashtu. Dhe atëherë vjen deri te një kompromis i vogël kur, që e kanë bërë Mahmut Bakalli dhe Fadil Hoxha, kur Azem Vllasi, Azem Vllasi dhe këta komunistët e rinj, komunistët e rinj i kanë hequr komunistët e vjetër. Ata i kanë akuzuar se janë separatistë kanë qenë dhe i kanë mbajtur e kinse ata do ta rregullojnë situatën. Por nuk kanë arritur ta rregullojnë situatën. Pastaj shfaqet lëvizja serbe, rezistenca serbe dhe fillojnë mitingjet, popullizmi. Kështu që përnjëherë vjen popullizmi në. E unë bëhem politikan në kohën e popullizmit.

Erëmirë Krasniqi: A ju kujtohet viti '87 kur Millosheviqi ka ardhur në?

Momçillo Trajkoviç: Tani do të ju tregoj. Se për atë, për atë unë po flas, unë po, unë po, unë pra po shfaqem si politikan në kohën kur populli, populli serb del në sipërfaqe, kur, deri atëherë kanë heshtur. Njerëzit nuk dëshirojnë të heshtin, dhe pastaj, heshtin, pastaj nga një qëllim i mirë, që të bëhen probleme të vërteta, nacionalizmi serb, ata nationalistët e shfrytëzojnë atë pozicion që populli është në rrugë dhe pastaj hyjnë ata.

Dhe fillon, dhe shkojnë në skajshmërinë tjetër. Kështu që përnjëherë në vend se të zgjidhet problemi keni dy skajshmëri. Deri dje separatizmi shqiptar, demonstratat, kush nuk është i kënaqur me këtë e të tillë ka shumë, nuk po ndalohet ajo, kjo po shkakton që ana tjetër që është e pakënaqur nga ana shqiptare në fakt hyn në ekstremin tjetër. Hyn në, në institucionet, edhe, po i shtyn institucionet që e sjellin në pah Millosheviqin dhe më vonë fillon ajo që ka qenë.

Erëmirë Krasniqi: Kjo nuk është konsideruar si separatizëm në atë kohë kur serbët me atë disi...?

Momçillo Trajković: Serbët nuk janë separatistë, do të thotë, separatistët janë ata të cilët dëshirojnë pjesë të territorit ta ndajnë, e dini atë. E këta janë, ata janë unitaristë, ata janë unitaristë, ata janë, ata dëshirojnë të hiqet krahina, Serbia të jetë e unifikuar. E dini, që nuk ka krahinë autonome, sepse e dini, si, si, ekstremin tjetër. Dhe ato dy skajshmëri kanë krijuar problem. E pastaj, pastaj shfaqet, pastaj shfaqet rezistenca shqiptare, ai, dhe aty, aty e ka luajtur një rol të madh, rol historik e ka luajtur, e ka luajtur Ibrahim Rugova. Të cilin e kam njohur personalisht.

Pjesa e Tretë

Erëmirë Krasniqi: A ju kujtohet kur shqiptarët kanë protestuar në Kuvend në vitin '90?

Momçillo Trajković: Unë kam qenë brenda.

Erëmirë Krasniqi: (qesh) Na tregoni për këtë.

Momçillo Trajković: Po, unë kam, e keni, e keni në YouTube, fjalimin tim aty.

Erëmirë Krasniqi: E çka, çka keni folur?

Momçillo Trajković: E keni, unë aty kam thënë, “Republika e Kosovës nuk do të jetë kurrë”. Kështu kam thënë, por para kësaj kam thënë a e dini çka, aty, aty në fakt është treguar thelbi, aty tregohet qëllimi i shqiptarëve. Lëvizjes shqiptare, ajo seanca i tregon të gjitha ato. Pra, unë kam qenë nënkryetar i Qeverisë së Serbisë, unë më asnjë, nën kurrfarë kushte nuk kam mundur të marr pjesë në punën e atij kuvendi. Por prapë kam ardhur për tu shpjeguar disa gjëra. Dhe aty ka shpjegim për atë.

Pra atëherë është kërkuar ndryshimi Kushtetutës së Jugosllavisë, Kushtetutës së Serbisë dhe Kushtetutës së Kosovës. Shqiptarët, ai grupi në parlament, ai fillon, dëshiron ta formoj komisionin në atë kuvend në vitin '90, që të propozoj ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës. Por nuk dëshiron të merr pjesë në ndryshimin e Kushtetutës së Jugosllavisë dhe Kushtetutës së Serbisë. Pra, që të ndryshohet Kushtetuta e Kosovës, fillimisht duhet të ndryshohet Kushtetuta e Jugosllavisë dhe Kushtetuta e Serbisë dhe pastaj ndryshohet Kushtetuta e Kosovës. Por ata e injorojnë këtë. Dhe unë ju them atyre aty, “Ju keni të drejtë”.

Por një grup e ka bërë këtë, e di tani këtë, jo, ende nuk dua të them, e kam edhe një vit duhet të hesht, sepse jam përbetuar. Sepse jam përbetuar, unë e di kush e ka bërë këtë, kush i ka shkruar të gjitha këto, i kam. Dhe ata fillojnë, dëshirojnë ta formojnë Kushtetutën e Kosovës. “Neve nuk na intereson çka ka atje”. Unë them, “Nuk bën, nuk mundeni, nuk keni të drejtë. Nëse pas kësaj është ajo, që fshihet qëllimi juaj, e ky qëllim është që dëshironi Republikën e Kosovës”.

Dhe atëherë kam thënë që Kosova Republikë është qëllim për luftë. Ju nuk mund ta fitoni Republikën e Kosovës me paqe, vetëm t'i merrni armët, ta fitoni Serbinë dhe pastaj ta fitoni republikën. Janë këto, të gjitha këto në librin tim, është libër i shkëlqyer. Është një dokument i mirë, unë kam, kush e ka, shumë shqiptarë e kanë. Unë e kam dhënë, Baton Haxhiu e ka këtë libër. Unë i kam thënë, "Lexoje librin, më thirr të vij të flasim në studio." Kurrë nuk më ka ftuar.

Dhe i ndjeri Demaçi, ai ka dashur të flas me mua, ta bëj një intervistë, më herët i ka bërë disa intervista. Unë i kam thënë, ai ka dashur të xhiroj, me të gjithë ka punuar drejtpërdrejt, me mua ka dashur të xhiroj, jo vetëm drejtpërdrejt të flas. "Nuk mund të vi unë aty e ti t'i presësh pastaj, dua këtë, dua atë." Pra, ky ka qenë problemi, atëherë është treguar se shqiptarët si kundërpërgjigje në atë tani në vitin '89 kur antari është ndërruar, amandmani 49, unë atëherë nuk kam qenë, atëherë nuk kam qenë atje.

Atëherë ka qenë Vule Jukanov, Hashi Jukanoviq, ata tregojnë hapur se çka dëshirojnë. Unë atëherë u përgjigja, "Ju mund të bëni çfarë të doni, por Republika e Kosovës nuk do të jetë." Dhe unë edhe sot pa marrë parasysh çka është dhe ku është, Republika e Kosovës në atë variant, ashtu si dëshiron, nuk do të jetë. Duhet të bëj kompromise, ja, kompromisi nëse Republika e Kosovës nëse vjen deri te ndryshimi i kufinjëve, e nëse Veriu i Kosovës nuk i takon Serbisë, pra nuk është ajo Republikë në atë, në atë kuptimin burimor si ata dëshirojnë, nuk mund të ndodh ashtu. Prandaj, duhet të flitet.

Aty jemi, ku kemi ardhur, tani do të shohim nga do të del e gjithë kjo. Pra, ajo deklarata rrugore, unë e di kush e ka shkruar. Shqiptarët nuk e kanë shkruar. Atë e ka shkruar shërbimi, ja ja të ju them unë, shërbimi i sigurisë, kurse ajo është komunikuar përmes, atë vetëm e kanë paraqitur grupi i delegatëve shqiptarë që ka punuar për atë shërbimin. Atë e dinë, ata që kanë qenë në Kaçanik, thonë se Kushtetuta e Kaçanikut, fillimisht nuk e ka shkruar, nuk e kanë shkruar ata që dëshirojnë monumente tani. E ka shkruar shërbimi.

Shërbimi, siguri shtetëror e ka shkruar dhe e ka dërguar në Kaçanik. Paramendoni tri, katër, shërbime të sigurisë, e ushtrisë, civile, jugosllovene, serbe, kosovare e ata në mënyrë të fshehur mbajnë takim në Kaçanik. Ata i kanë dërguar atje, t'i bëjnë këto. Përse, tani unë për këto nuk guxoj të flas. Unë burimet, unë, unë nuk kam marrë pjesë në ato por e di, kam informata, e di për çka bëhet fjalë. Unë këtë ia kam thënë Fatmirit Limajt, Thaçit, unë i kam. A e shihni a shënohen ato dy data? Dy korriku është, rrugor, dy korrik dhe sa shtator? Kur është Kushtetuta e Kaçanikut, i nënti, jo? Kur është?

Erëmirë Krasniqi: Nuk është e njohur, nuk është ky i dy korrikut.

Momçillo Trajkoviq: Jo, 2 korriku është...

Erëmirë Krasniqi: Kushtetuta e Kaçanikut.

Momçillo Trajković: Jo, dy korriku është deklarata para Kuvendit. Ndërsa, në muajin shtator është Kushtetuta e Kaçanikut, tash nuk e di me sa shtator. Paj shikoni, aq është e rëndësishme ajo datë sa që as nuk e di, nuk e dini as ju, nuk e dinë. Dhe mua më ka thënë Fatmiri që, kur unë atij i kam thënë, “Çka po festoni, a e dini se kush e ka shkruar atë?” Ai mua më thotë, “Këta po kërkojnë përmendore”. Tani mua më thotë kërkojnë përmendore.

Pra, nga kjo, nga kjo bisedë e imja dhe më vonë kur kemi shkuar të takohemi, unë e hap atë çështje. Ndoshta dy korriku shënohet diku rrugës, por dy korriku është datë e rëndësishme. Dhe dita e Kushtetutës së Kaçanikut në historinë e shqiptarëve është datë e rëndësishme. Por edhe njëra edhe tjetra datë janë të krijuara nga ana e shërbimit. Aty është i gjithë, i gjithë problemi prandaj edhe nuk festohet. Prandaj nuk festohet, ja shikoni, do të shohim dy korriku a do të, e dini çfarë do të thotë.

A është shënuar vitin e kaluar 2 korriku? A e keni përcjellur ju këtë?

Erëmirë Krasniqi: Jo.

Momçillo Trajković: Po nuk e keni përcjellur, më herët kur është festuar nuk e di cili, shtatë korriku në Serbi apo 13 korriku në Mal të Zi apo katër korriku në Jugosllavi. Ajo nuk festohet, ajo nuk festohet përse, sepse ata e dinë, aty Millosheviqi ka luajtur. I ka bërë lëvizjet që më parë i kanë kushtuar. Unë e di këtë shumë mirë.

Erëmirë Krasniqi: Kur keni marrë vendim të shkoni, të jepni dorëheqje nga Këshilli Ekzekutiv?

Momçillo Trajković: Cili Këshill Ekzekutiv? Jo, atëherë unë jam zgjedhur, jam zgjedhur. Mua, mua më kanë dërguar në Kumrovec, në shkollën politike. Mua më ka dërguar...

Erëmirë Krasniqi: Në vitin ‘90? Jo, jo, jo, po flasim për vitin ‘91 dhe atëherë kur jeni përleshur me...

Momçillo Trajković: Millosheviqin?

Erëmirë Krasniqi: Me Millosheviqin, si keni marrë vendim të heqni dorë, si e keni bërë këtë, a ka qenë ky vendimi juaj?

Momçillo Trajković: Ka qenë,ka qenë. Millosheviqi e ka pasur një grup këtu, është quajtur Bozhur, Kecman dhe ajo shoqëri i ka disiplinuar politikanët serbë. Dhe ata shkruan kundër meje dhe kundër Toma Sekulliqit, Toma, nuk e di a e dini ju se kush është Toma Sekulliq. Ai ka qenë një, një njeri i madh, mik i mirë i imi. Ata më sulmojnë mua dhe Toma Sekulliqin se si ne po bashkëpunojmë me separatistët shqiptarë, si. Mua më kanë sulmuar që unë do të, si është quajtur ai kryetari para, pas Enver Hoxhës?

Erëmirë Krasniqi: Ramiz Alia?

Momçillo Trajković: Do t'ia dorëzoj Kosovën Ramiz Alisë dhe Ibrahim Rugovës, unë e kam atë. Ta dorëzoj Kosovën, dhe si po takohem fshehurazi me opozitën serbe, me Vuk Drashkoviçin de të tjerët. Mua më akuzojnë, e unë nënkryetar i Qeverisë, dhe në ora shtatë e gjysmë po lexojnë te Ditari. E dini kur lexohet në shtatë e gjysmë, e di që është Millosheviçiqi dhe gruaja e tij, e kan aprovuar atë. Sepse e di se si shkon politika. Dhe unë e thërras atë, përndryshe kemi komunikuar me "ti", unë kam qenë me Millosheviçin në "ti" kur kemi, kur unë dhe ai flisnim.

“Çka ishte ajo?” E pyes unë, “Çka ishte ajo mbrëmë në Ditar?” Thotë, “Po asgjë ajo, hajt...” “Po, si asgjë?” Them, “Hajde”. Përndryshe unë kam qenë te ai, me këmbë e hapja derën, unë kur kaloj vetëm e përshëndesja sigurimin, askush nuk më ndalon. “Të vij” i them, “të vj deri te ti?” Unë kam qenë aty te Kuvendi i Serbisë, e ai ka qenë aty përballë. Thotë, “Jo, jam i zënë”. Për herë të parë më ka thënë se është i zënë. Unë zbres poshtë, pa pyetur, afër sigurimit, shkoj tek sekretarësja hyj brenda, ai po del.

Thotë, “Ti ke ardhur?” “Kam ardhur”. “Hajde,” thotë, “brenda”. Hyra unë brenda, ai më thotë, unë po e pyes atë, “Çka është, çka është, si mund të ma bëje atë ti mua mbrëmë në?” “Hajt lëre atë,” thotë, “lëre atë, nuk është ajo”.

[Intervista u ndërpre përshkak të problemeve teknike]

“Hajde” më thotë ai mua, “Paj, më duhet”, thotë, “Ty edhe atij Toma Sekulliqit”, Millosheviçiqi thotë, “Ty edhe atij Toma Sekulliqit dua të them”, “Çka ke të thuash ti?” “Ulu!” Unë ulem. Ai mua më thotë, “Për [lëviz dorën, tregon sharje] ju, serbët vendas, si shqiptarët në vitin ‘81 shumë herët keni filluar të këndonit”. Sepse Toma Sekulliq dhe unë, pas nuk e di sa dekadash jemi serbët e parë të vjetër që kemi marrë ndonjë funksion. Sepse këtë popull më së shpeshti e kanë sunduar Malazezët.

Pra, në Kosovë, të ju them, në Kosovë pushtetin e kanë ndarë malazezët, pastaj malazezët shqiptarë, kurse serbët vendas më vonë. Pasi që në Kosovëlëvizjen kombëtare, atë lëvizjen partizane e kanë bërë malazezët, ata e kanë bërë atë lëvizjen. Serbët vendas kanë qenë më të rezervuar karshi gjithë kësaj. Ata madje edhe më herët kanë qenë të rezervuar karshi mbretit, e monarkisë. Ata ma shumë e kanë dëshiruar atë, se që kanë qenë të guximshëm sepse, unë ju kam thënë juve, arma kryesore e këtij populli është durimi.

Ata kanë duruar edhe kur është dashur të hyjnë, gjithmonë kanë qenë të rezervuar dhe nuk kanë hyrë masivisht në lëvizje. Në, atë lëvizjen nacional-çlirimtare, lëvizja partizane. Kush ka hyrë në mënyrë masive? Malazezët edhe pse ata, por ata janë malazezë të ardhur, që janë shpërngulur me kolonizim. Ata me, me ardhjen e malazezëve dhe hercegovëve këtu ka ardhur edhe ideologjia komuniste. Ka ardhur edhe ideologjia e qetnikëve por jo në atë masë. Pasi që ata janë të pamëshirshëm, ndërmjet vete janë përplasur kështu që ajo lëvizja qetnike që ka qenë më e vogël, i dobët aty është shkatërruar. Dhe mbeti lëvizja e partizanëve.

Pra, edhe pas luftës, unë kam thënë, atëherë ata edhe e kanë krijuar partinë komunistë të Shqipërisë, ata kanë zgjedhur që Enver Hoxha, Ramiz Alija dhe të tjerët të jenë prijës të asaj, të asaj lëvizje komuniste. Ata e kanë zgjedhur grupin e shqiptarëve në krye me Fadil Hoxhën të jenë përfaqësues të komunistëve, të rendit partizan dhe komunist. Dhe deri në vitin '66, këtu kryesisht kanë sunduar malazezët përkrah grupit të atyre komunistëve shqiptarë. Kur pas vitit '66 kur ka ardhur deri tek përplasja ndërmjet tyre, kur ka qenë me Rankoviçin atëherë, të gjithë ata që kanë qenë në krye, më së shpeshti në krye, ata kanë qenë kryesuesit e Udba-s, policisë, pylltarët, seretarët e komitetit, të gjithë malazezë.

Sepse ata edhe kanë marrë pjesë sikur tani UÇK, sepse ata kanë marrë pjesë në atë lëvizje. Serbët vendas janë lënë pas dore, nuk ka qenë masivisht në atë lëvizje. Janë lënë pas dore dhe nga ana tjetër ka filluar emancipimii shqiptarëve, por jo i serbëve vendas. Shqipatrët dhe serbët vendas kanë jetuar këtu së bashku me shekuj, me kushte të ngjashme apo të njejta historike, ekonomike, sociale. Megjithatë vjen deri te emancipimi i shqiptarëve nga ana e politikës së Titos, përkatësisht politikës komuniste, përkatësisht malazezëve.

E serbët janë të emancipuar bash për atë se malazezët e kanë udhëhequr politikën dhe vet fakti që ata tashmë kanë qenë të edukuar, e serbët janë të emancipuar. Populli, në thelb, ky këtu nuk ka qenë i kyçur në emancipim. Kështu që ju keni pasur eman, ka filluar një emancipim i madh i shqiptarëve, por edhe serbët vendas përnjëherë janë harruar, ata kanë qenë nëntëdhjetë e pesë përqind. Pesë apo dhjetë përqind kanë qenë kolonistët malazezë. E nëntëdhjetë përqind populli serb vendas për të cilin askush nuk është shqetësuar.

Nëse unë {tregon me dorë kah vetja} them që jam intelektual i parë që e ka përfunduar fakultetin në Çagllavicë, në tri kilometra larg Prishtinës, atëherë ju, keni përgjigje që në atë kohë shqiptarët kanë shkuar larg me emancipim. Sepse politika e Titos e ka dashur këtë, përkatësisht politika që ata këtu e kanë udhëhequr, dhe Toma Sekulliq edhe unë kemi qenë politikanët e parë serioz në mesin e popullit serb vendas. Këtë nuk ka mundur ta duroj ai opsioni karrierist malazez që nuk ka mundur të kuptoj që disa serb vendas mund të jenë para tyre.

Dhe pastaj ajo, atëherë kjo është bartur te Millosheviqi. Toma Sekulliq i pari i është kundërvënë Millosheviqit. Pastaj Millosheviqi e ka kuptuar. Toma Sekulliq i pari i është kundërvënë Millosheviqit. Unë e kam përkrahur Toma Sekulliqin dhe ajo përkrahje për Toma Sekulliqin më ka kushtuar.

Erëmirë Krasniqi: E si i është kundërvënë ai?

Momçillo Trajkoviç: Ai është, a i është kundërvënë për shembull, ja çfarë do të ju them, unë e kam njoftuar Toma Sekulliqin dhe Millosheviqin. Unë Millosheviqin e kam njohur në vitin '86, kurse Tomën, Toma Sekulliqin e kam njohur me të në vitin '88, dy vite më vonë, në prill të vitit '88. Kjo është shumë

interesante të shihet. Dhe një ditë mua Millosheviqi më thotë, “Hajde ma sillni, sillne ta njohim atë Tomën tonë”. Dhe unë një ditë në vizitë në mbrëmje jemi marrë vesh të mbërrimë në mbrëmje, Millosheviqi ende atje nuk e ka pushtetin e fort, aty është Siguria federale e shtetit, e përcillnin, çfarë po bën dhe kështu me radhë.

Dhe shkojmë ne atje, nuk e di, më duket kati i nëntë apo i dhjeti në KQ atje, në Ushqë ajo ndërtesa e madhe. Po hyjmë, po shkojmë deri te sekretarësja, del Millosheviqi, unë them, “Ja ky është Toma jonë”. Dhe tani ne po shkojmë në drejtim të asaj sallës, po e pyet Toma Sekulliqi Millosheviqin, për herë të parë po shihen, “President, si po shkojnë këto gjërat tona?” Po e pyet Toma, Millosheviqin. Ky po thot, “Po shkojnë,” thotë, “perfekt, të gjitha në favorin tonë”. Thotë, “Po shkon perfekt”. Toma ulet, dhe po ulemi të gjithë dhe ai, i thotë Millosheviqit, mbane mend këtë, këtë shqiptarët do ta kuptojnë shumë mirë, “Kosit agë, por bëj kujdes shiu të mos e kap kositjen”. E dini çfarë do të thotë kjo?

Ta kositësh livadhin, por kujdes nëse shiu bjen e ti e ke kosit, gjithçka do të dështoj. E Millosheviqi ka qenë inteligjent. Ka qenë shumë i shkolluar, Millosheviqi. Nuk ka lexuar shumë libra në jetën e vet por ka qenë inteligjent. Ai i thotë Tomës, “Dëgjo Tomo, unë do të të përgjigjem me citimin e Knjazit, në përmendoren e Knjaz Milloshit në Pozharevc shkruan kështu, Delibash, djal i ri, ti mund të shkosh andej ose këndej e unë jam nisur drejt për jetë apo vdekje”. Unë atëherë e kam parë se nga po shkon e gjithë kjo. Millosheviqit kjo nuk i ka pëlqyer, dikush për herë të parë t’i thotë ashtu, puno por kujdes se mos të dështon e gjithë kjo.

Çka edhe i ka ndodhur. Dhe që ka ndodhur edhe ajo që ai e ka thënë, pra atëherë, kjo është te libri im, ka, e kam cituar. Kjo ka qenë përplasja e parë serioze. Përplasja e dytë ka qenë, sheshi i vjetër, minatorët në sheshin e vjetër. Rrahman Morina ka qenë kryetar i komitetit, e Toma Sekulliq ka qenë sekretar i komitetit. Pra ata dy kanë qenë tandem.

Atëherë minatorët kanë kërkuar dorëheqjen e Rrahmanit, Ali Shukrisë dhe Husamedin Azemit. Dhe organizohet seanca, Shuvar e organizon si kryetar i KQ, e organizon seancën e kryesisë. Unë për këtë kam shkruar, gati edhe me Azemin, ata nuk e dinë këtë, nuk e dinë, moti është ajo. Dhe pasi Rrahmani, pasi ka punuar Rrahmanit, Rrahmani nuk shkon për Beograd por e dërgon Toma Sekulliqin si sekretar, si zëvendësin e tij. Dhe Toma shkon te Millosheviqi, kthen që së bashku të shkojnë në seancën e kryesisë së KQ.

Dhe tani, Slloba Millosheviqi i thotë Tomës, “Tomo, e di si do të paraqitemi, shkojmë atje, i përkrahim, nuk, nuk, nuk pajtohem për dorëheqje, nuk mund të kalojnë”. Por Toma atij i thotë, “Dëgjo,” thotë, “Sllobo, por unë mendoj ndryshe”. “Si mendon?” “Unë mendoj që për tre shqiptarë nuk duhet t’i shkëpusim të gjitha marrëdhënjet me shqiptarët. Unë mendoj se ata duhet të jepin dorëheqje dhe të shkojnë” {merr frymë thellë}. “Po a je ti normal?” (qesh) I thotë ky Millosheviqi Tomës. “Unë mendoj kështu”. Dhe kap’ e mos lësho, kap’ e mos lësho, këta lart, po pret seanca e kryesisë të filloj.

Dhe bashkë ta shkojnë atje dhe ka menduar që Toma nuk do ta thotë këtë dhe do ta ndërroj mendimin. Dhe kur lart fillon seanca, fillon Shuvari, Raçani, Kuçani. Përndryshe unë personalisht me Raçanin edhe sot personalisht, deri në vdekjen e tij kam qenë mik i tij personal. Ai ka qenë drejtor i shkollës, kështu, në Kumrovec, unë kam qenë, kam qenë në atë shkollë. Atëherë kemi qenë atje, jemi bërë miq. Dhe tani fillon seanca, të gjithë diskutojnë, lajmërohet Toma Sekulliq dhe e përsërit këtë. Thotë, “Unë mendoj që ata duhet të jepin dorë heqje. Për tre shqiptarë, për tre shqiptarë nuk do t’i ndërpresim marrëdhënjet me popullin shqiptar”.

Seanca zgjat, Millosheviqi nuk ka përkrahje, kurse në atë kohë Millosheviqi e ka thirr popullin në qendër para Lidhjes së Kuvendit. Ka ardhur populli, atëherë viti ‘88, dhe kap’ e mos lësho, kush e përkrah atë Borkovski e përkrah Millosheviqin dhe ai, njëfarë Renovica, Renovica, si është quajtur ai nga Bosnja, e përkrahin. Pastaj, derisa ka zgjatur seanca Millosheviqi e ka thirr Borisllav Joviqin dhe Raif Dizdareviqin, nuk e di nëse i njihni ata, a keni dëgjuar. President ka qenë president i Jugosllavisë, të shkojnë t’i flasin popullit. Seanca zgjat një orë më shumë. Dhe Millosheviqi e përfundon seancën, Millosheviqi shkon atje në tubim, dhe atëherë ka thënë, “Do ta burgosi Vllasin”.

Kur kanë thënë do ta burgosim Vllasin, ajo ditë ka qenë. Dhe ka thënë atëherë Millosheviqi, i zemëruar me Toma Sekulliqin, ka thënë, “Do ta burgos Vllasin”. Dhe çka do të ndodh, askush nuk dëshiron të besoj sepse unë kam qenë, unë kam qenë njeri shumë i rëndësishëm i Millosheviqit, të cilin, të cilit ai i ka besuar mjaft dhe e ka pyetur. Nuk më ka dëgjuar gjithmonë por më ka pyetur. Më thirr ai mua, ka kaluar gjysmë ore nga ai mitingu, Millosheviq më fton mua në zyre sepse unë kam qenë në lidhje me të. Dhe ma shan nënën. Thotë, “Çfarë mënyre është kjo?” Them, “Për çka po bëhet fjalë? Çka është kjo?” “Si për çka po bëhet fjalë? Unë e kam vendosur kokën brenda thesit e ai Sekulliqi ashtu. Ti e ke sjellur tek unë, ti më ke...”

“Çka u bë njeri?” “E ka përkrahur” thotë, “Raçanin dhe Kuçanin dhe Shuvarin” {psherëtimë mosbesimi}. Edhe mua më është dukur atëherë e çuditshme, mendoja po ia tepron, nuk është ajo, megjithatë ka qenë koha ashtu. Toma vjen në mbrëmje nga Beogradi, unë shkoj tek ai dhe e pyes, “Tomo, a është e vërtetë?” Thotë e vërtetë. Unë e kam shkruar këtë në libër, aika, deri sa ka qenë i gjallë ka dal libri. Ai është pajtuar me këtë. Aty ka qenë përplasja e dytë e madhe. Dhe përplasja e tretë ka qenë kur u bë strategjia për Kosovën, e Millosheviqit. Paqja, demokracia dhe kur Millosheviqi ka shkruar në atë strategji që do t’i kthej njëqind mijë serbë, a ju kujtohet kjo?

E ka shkruar atë programin, për paqe, demokraci, për Kosovë. E ka miratuar KQ, KQ-YU, të gjithë e kanë miratuar. Dhe ai aty shkruan që në atë program, Serbia do ta bëj këtë, këtë dhe këtë, ndër të tjera, do t’i kthej njëqind mijë serb për pesë vite.

Erëmirë Krasniqi: Do t’i bjerë apo do t’i kthej prej nga?

Momçillo Trajkoviq: T’i kthej, serbët që janë shpërngulur, t’i kthej në Kosovë. Njëqind mijë, për...

Erëmirë Krasniqi: Në cilën kohë, në cilën kohë janë shpërngulur serbët?

Momçillo Trajković: Paj janë shpërngulur këtu fillimisht njëqind mijë serb, nuk kanë mundur të kthehen nën, politika e Titos e ka ndaluar kthimin e serbëve kolonistë të cilët kanë ardhur më herët. Kanë ardhur kinse në tokën shqiptare kurse njëqind mijë nuk kanë mundur të kthehen. Kjo ka qenë, kjo ka qenë, e ky tani thotë, “Do t’i kthej njëqind mijë serb”. Dhe ne atë, kemi qenë unë dhe Toma. Na ka thirr Millosheviqi në Nish, atje ka qenë grupi punues. Ne kemi shkuar të bisedojmë, unë dhe Toma nuk jemi pajtuar me këtë.

Ne i kemi thënë, “Mund t’i kthesh edhe një milion, por nuk duhet të shkruaj aty. Me atë vetëm mund t’i irritosh njerëzit”. Ai jo, dhe ai e ka lënë. Në KQ kur kemi qenë, pasi që Toma dhe unë kemi qenë antarë të KQ Serbia. Në seancë Toma del prapë, para atëherë para gjithë botës dhe thotë, “Kjo duhet të fshihet”. Dhe ky ka qenë fundi. Dhe pastaj pasi që unë dhe Toma, kemi qenë serb vendas të vjetër, përshkak se ne jemi njerëz më të fortë, pak më ndryshe mendojmë ne nga këtu, këtu kemi çdo gjë tonën.

Prandaj ai mua më ka thënë se me kundërshtimin kemi gabuar ne serbët vendas sikur shqiptarët në vitin ‘81, shumë herët keni filluar këngën. Pra sikur në vitin ‘81 shqiptarët para kohe ndoshta, është dashur të presin (qesh) kështu edhe ne është dashur të presim, por jo ne e kemi tejkaluar dhe kështu me radhë, e kështu me radhë. Dhe unë kam thënë, e kam pyetur, “A e ke lexuar ti ndonjëherë Rakiqin, Millan Rakiqin?” Keni dëgjuar për Millan Rakiqin, Nushiq Branislavin, ata kanë qenë konsuj në Prishtinë. Atëherë Janiqija Popović, intelektual i njohur nga Graçanica. Atëherë Grigoriye Bozhović, i njohur ky, shkrimtar, poet.

“Nëse i ke lexuar ata, atëherë duhet ta kesh të qartë përse unë dhe ti sot po flasim për serbët e Kosovës. Po të mos kishte serb vendas të vjetër sot ne as nuk do të flisnim, moti ata do të shkonin dhe problemi do të zgjidhej”. Dhe unë them, “Dëgjo, babai im i ndjerë mi ka lënë katër hektarë toke”. Jo, ai më ka thënë para kësaj, “Hajt”, thotë, “hajt thotë shko pajtohu me Kecmanin, me atë budallain”. Njëfarë bokseri. Sa shumë ndikim ka pasur në politikën serbe, ai Kecmani. Ai i ka disiplinuar politikanët serbë të cilët nuk, të cilët, kësi, në pozita. Thotë, “Shko pajtohu me të dhe shkojmë tutje”.

Unë i kam thënë, “Dëgjo, Slobodan,” kështu i kam thënë, “Dëgjo Slobodan Millosheviqi, i ndjeri Aca Trajković, mi ka lënë katër hektarë tokë në Çagllavicë. Po shkoj të kullos bar”. Dhe unë ngritem, ai, “Ndal!” Unë shkoj tutje. “Ndal!” E kap unë dorezën, thotë, “Ndal!” Dhe unë kthehem. Kurse ai mua më thotë, “E unë kam menduar që ti je i gatshëm për funksionet më të larta në këtë shtet”. Dhe unë e hap derën, në vete e shaj (qesh) shkoj dhe kurrë më nuk jemi parë.

Kemi pasur ende mosmarrëveshje, si të veprojmë më tutje me Kosovën. Unë dhe Toma e kemi pasur një këndvështrim tjetër. Por ai atë, ai nuk ka dashur të dëgjoj këtë. Dhe atë moment kur ai është ndarë

prej neve dhe e ka pranuar atë politikën tjetër të atij grupi, grupit karierist malazez, atëherë ai ka shkuar atje ku ka shkuar dhe para kësaj unë e kam pasur një bisedë me të. E kam apsur një intervistë në “NIN”, në librin tim është ajo intervistë në “NIN”. unë çdo vit i kam pasur nga dy intervista në “NIN”, e të kesh intervistë në “NIN” e dini, nuk e di sa e dini se çka është “NIN”. Është një revistë e fuqishme politike dhe tani dikush t’i ketë dy intervista brenda javës, brenda vitit.

Unë atëherë kam apsur dhe atëherë ju kam thënë, “Mos e hiqni shikim nga ne, nga Kosova”. Dhe atëherë për herë të parë kam deklaruar, ka qenë i dyti janar, unë e kam dhënë në dhjetor, në fund të dhjetorit, më dy janar ka dal, në vitin ‘92. Ajo intervistë ku e kam deklaruar mosmarrëveshjen me të. Të mos mashtrohem, ajo që i’a ka lënë aparatit zyrtar të Kosovës, njerëzve për, për Papoviçin ka shkruar “Serb gabim, serb i madh në kohë të gabuar”. Kur është dashur të jetë serb, ai ka komplotuar me këtë Rozhajn, e ka dëgjuar për çdo gjë, kupton.

Ishte udhëzues i tij. Kur e gjithë kjo ka kaluar, ai tash ka filluar i madh, kur tani është dashur të jetë i mençur, kur i mençur, kur është dashur të gjindet gjuha e përbashkët ai po bëhet serb i madh. Dhe, dhe kështu, ajo, ajo, atëherë ata kanë spastruar çdo gjë që ka mbetur nga shqiptarët, ata kanë spastruar, dhe kështu ka qenë.

Pjesa e Katërt

Ka dështuar, ajo mua më ka ikur dhe pastaj kam qenë jashtë, atëherë e kam formuar partinë social-demokrate të Serbisë. Pas Tucoviçit unë kam qenë kryetar i ardhshëm i partisë social-demokrate të Serbisë. Më tre prill, më tre prill të vitit ‘93. Unë jam zgjedhur për kryetar të partisë social-demokrate të Serbisë. Unë e kam braktisur Millosheviçin dhe e kam formuar grupin tim dhe e kam filluar partinë social-demokrate të Serbisë. Atëherë jam takuar me peshkopin Artemije dhe me të kam qenë dhjetë vjet.

Ne kemi qenë të pandashëm, deri më dy prill të vitit 2000 kur jemi ndarë. Dhe politikisht jemi ndarë. Do të thotë ne e kemi kaluar gjithë botën. Kemi folur në të gjitha parlamentet botërore të fuqive të mëdha, në Kongresin Amerikan, në State Department, në parlamentin britanez, në parlamentin francez kemi folur, në Bundestag, në Dumën ruse, nuk ka vend që nuk kemi folur. Jemi takuar me Klintonin, Ollbrajt, me Kofi Ananin.

Unë kam folur, unë kam menduar se unë jam politikani i parë nga Kosova i cili ka folur në Këshillin e Sigurimit. Edhe prej shqiptarëve edhe prej serbëve. {lëviz dorën} Dhe të gjithë më vonë, edhe Rugova, dhe të gjithë më vonë, të gjithë kanë folur pas meje. Unë atëherë kam qenë, atëherë, pra një jetë e trazuar, një karrierë e trazuar e njeriut i cili, ka dal nga një dhomë, nga një dhomë në të cilën kemi fletur të gjithë, e në dhomën tjetër kanë fletur kuajt dhe lopët (qesh). E shihni si është, si është, si është kjo e mundur. Kur kam qenë në Këshillin e Sigurimit, për shkak se babai im ka pasur dëshirë që

t'i, ne kemi biseduar shpesh dhe thoshte, "Bir, unë e shoh që ti po i kupton këto, pse nuk po hyn në politikë?" Pra unë me 36 vjet kam hyrë në politikë. Dhe kështu kam filluar andej-kënde, ai vdes me të dytin, tani është, të shtunën janë bërë 33 vite që ka vdekur. Dhe unë më dy prill, pas dy muajsh hy në politikë.

E ai i shkreti nuk ka ditur asgjë, dhe kur flisja për Këshillin e Sigurimit, ai patkoi {tregon me gisht} e dini si duket ajo, ku rrin ulur, ku rrinë ulur Daçiçi dhe Vuçiçi, përkatësisht nga ana tjetër {tregon me gisht nga ana tjetër} ulet (qesh) por aty ku ulet Daçiç, aty jam ulur unë, dhe Vuçiç. {tregon poshtë} Në atë karrigen e presidentit, unë u qova, dhe tani të gjithë ambasadorët u ulën. Unë po e bëj kryqin {bën kryqin} e di unë po e bëj kryqin e ai murali i madh atje. Po e bëj kryqin dhe po them, "Babi" flas me babain tim, "Kemi hipur në kulmin e politikës botërore". Dhe kjo për mua ka qenë me të vërtetë, ata njerëzit po shikonin (qesh) e dinë.

"Kemi hipur në kulmin e politikës botërore". Pra ja si mundet një, një njeri që ka bartur qumësht (qesh), i cili ka jetuar aty si ka jetuar, çfarë rruge e shkëlqimit dhe rënies është. Unë, unë dy herë, unë kam ardhur në vitin '91, pra kam ardhur në konflikt. Kam hipur në maje botërore, kesi, të politikës serbe, politikës jugosllave. Kam qenë do të thotë njeri i fuqishëm. Pas Millosheviqit, unë kam qenë më i fuqishmi. Ndoshta ministri i Punëve të Brendshme ka qenë më i fuqishëm se unë.

Por përse, sepse Millosheviqin Kosova, Millosheviqin e ka krijuar Kosova e ai mua më ka vendosur në krye të Kosovës. Kjo do të thotë që kjo, por kam zgjatur pak. Unë po të mos, po të mos e bëja atë, unë me siguri do të isha në Hagë. Mua më ka zëvendësuar Shajnoviq, më vonë nga Kosova e ka zhvilluar politikën Shajnoviqi. Pra, mua Zoti, pak mençuri e pak Zoti, më ka ndihmuar. Edhe pse unë jam i sigurt se edhe po të mbetesh, unë nuk do të bëja atë që kam bërë. Sepse kush jam unë e kam treguar në kohën e luftës, kur ju kam ndihmuar njerëzve. Pothuajse gjithmonë jam frikësuar pas luftës, jam frikësuar.

Po të frikësohesha shumë as që do të shkoja por për dikë nuk ka qenë njejtë kur kaloja, nga, nga Ravniku kur e kaloja edhe Podujevën, nuk më dukej asgjë e pazakontë. Por Besi, e dini ku është Besia? është aty kur shkon tani, Besiamenjherë {tregon drejtimin} Devet Jugoviqi, Besia po, Prugovac. Dhe aty në kohë të luftës, para të them, para diku dhjetë vitesh unë, vonë kam shkuar, shkoj për Beograd, nuk kam blerë një suxhuk për ta dërguar. Dhe ndalem në shitore në Besinjë, menjëherë nga ana e djathtë {tregon anën e djathtë} është shitorja, ora 11 në mbrëmje.

Për të blerë, unë hyj brenda, vetëm unë, në arkë punon një njeri, dhe një njeri pas meje. E gjithnjë jam frikësuar kur kam kaluar andej. Disi nuk ka qenë (qesh). Dhe unë bleva, i mora të gjitha, atëherë vij deri te arka, më thotë ai, "Trajkoviq?" "Po." "A je ti?" Them, "Unë jam." "Dëgjo" thotë, "ti më ke dhënë cigare në kohë luftime." Më kujtohet, më kujtohet mua kjo. Thotë, "Jo mua, por" Baca, Bajramit apo Shaban Dragushës, unë mendoj që ka qenë Shaban Dragusha. Baca, ka qenë një njeri më i moshuar.

“Dhe besom ti, Trajkoviq” thotë, “këtu ata që kemi qenë, sepse ti je njeri i njohur” dhe ata flasin, e di shqiptarët atje tash flasin, shqyrtojnë (qesh) gjëra të ndryshme.

“Kur ty të përmendin në kuptim negativ” thotë Baca, Shaban ose Bajram, nuk e di, Shaban po “Hidhet” thotë, “Mosni njerëz, nuk është ashtu.” {lëviz gishtin} Dhe ai e tregon, e si ka qenë në kohën e luftës, në kohë lufte unë nisem për Beograd, me veturë dhe kur kam ardhur te prugovci një grup njerëzish, gra, të lodhur, i kanë rraskapitur këta, ju kanë marrë traktorët. Përkatësisht, nuk kanë pasur naftë, {lëviz dorën} dhe ata qëndrojnë të ulur të gjithë. Dhe unë, ata kanë qenë nga ana e majtë {tregon anën e majtë me dorë} unë po shkoja për në Beograd, nga ana e majtë.

Dhe vij deri te ata, e hap xhamin, nuk dal nga vetura. “Mirëdita.” “Mirëdita.” Kur më shohin njerëzit, po e shoh e ndryshojnë ngjyrën, nuk e dinin nëse unë tani me automat {simulon qitje me armë me duart e tij} bam, bam, bam, përfundoi. E tmerrshme ka qenë, për besë. “Si jeni njerëz?” unë sa di shqip, “Si jeni njerëz?” Them, “Do të bëhet mirë, do të bëhet, do të kaloj edhe kjo, çdo gjë do të rregullohet.” Unë kam pasur boks të cigareve, përndryshe nuk pi duhan. Kam pasur boks të cigareve, dhe unë e marr atë boksën e cigareve dhe them, “Urdhëroni.” {bën me duar sikur e zgjat}

Shikojnë, presin tash, shiko, deri atëherë nuk ma kanë përmendur emrin, thotë, “Trajkoviq, ti je?” Them, “Unë.” Dhe kështu, çuditet, a është e mundur. “Përshëndetje.” “Përshëndetje.” Dhe paramendo ti pas kaq vitesh, e unë gjithnjë jam frikësuar kur andej, palidhje, kam kaluar. Mua njeriu në mes të natës, në dyqan më thotë, “Ti më ke dhënë cigare.” Pasi që mua më ka përcjellur ajo, SHIK-u më ka përcjellur, pasi që kam qenë...

Erëmirë Krasniqi: A mund të flasim pak rreth bombardimeve? Ku keni qenë gjatë asaj kohe dhe si e keni?

Momçillo Trajkoviq: Po, po, në atë kohë, në atë kohë...

Erëmirë Krasniqi: Ju keni qenë në qytet?

Momçillo Trajkoviq: Unë kam jetuar në Prishtinë.

Erëmirë Krasniqi: Po.

Momçillo Trajkoviq: Familja ka jetuar në Prishtinë. Unë kam punuar në Ratar, në Llaplla Sellë. Dhe tani vjen mobilizimi, që të shkohet në ushtri. Por pasi që unë, në pranverë, në muajin mars kam pasur korrje në punë, me qindra hektarë tokë. Dhe unë shkoj atje dhe them, “Njerëz na lironi, që ne të punojmë, që këtë {lëviz dorën} ta korrim, ta mbjellim. Dhe për zotin, ata e pranojnë, dhe e bëj unë listën e punëtorëve të mi dhe ata i lirojnë ata punëtorë nga shkuarja në luftë dhe neve, neve na jepin një orar për luftë për ta punuar tokën. Dhe kështu ne pasi që është pranverë po mbillnim.

Erëmirë Krasniqi: Kjo është '99 apo '98?

Momçillo Trajković: Viti është '99 muaji mars, po, ka filluar lufta, po. Dhe të cilët, por i kam njohur pak ata njerëzit atje, prapë unë kam qenë njëfarë, edhe pse kam qenë opozitë e Millosheviqit. Disi kam, kam, më kanë respektuar njerëzit. Dhe pas diku një muaji, jo, pesëmbëdhjetë ditëve nuk ka çka të hahet e unë e kam pasur tregun në Prishtinë, tregu nuk punon. Bombardime. Çfarë të bëj, shqiptarë nuk ka, serbët thoshin shkuan shqiptarët. Askush nuk del nga shtëpia. Dhe unë marr urdhër që ta furnizoj tregun. Çfarë të bëj, dy kamionë të mëdhenj dhe drejt për Beograd.

Disa para që i kemi pasur {lëviz dorën} i nxjerrim dhe shkojmë në tregun kuantik në Beograd, të blejmë mall. Dhe i mbush unë ata dy kamiona të mëdhenj dhe e di kur, kur kemi udhëtuar në drejtim të Beogradit në mbrëmje, avionët, ne i braktisim kamionët, ik nga këtu, që të mos na bombardojnë, a e dinë, (qesh) kjo ka qenë shumë e tmerrshme.

Erëmirë Krasniqi: (qesh)

Momçillo Trajković: Dhe të nesërmen vijmë ne, tani është qesharake (qesh) atëherë ka qenë shumë e tmerrshme. Vijmë ne në treg, i mbushim të gjitha tezat. Mall i ndryshëm, atëherë tashmë, tashmë ka qenë muaji prill. Ndoshta me njëzet e diçka mars ka filluar, tashmë ka qenë muaji prill. I mbushim tezat, specat, domate, pemë, patate, qyteti nuk ka çfarë të hajë. Hapet tregu, në radio e lëshojmë që tregu po punon, përnjëherë kur ka filluar të dal populli. {e vendos dorën në ballë} shqiptarët përnjëherë, si milingona, njerëzit e shkretë dilnin nga gropat, nga banesat ku kanë qenë të mbyllur, ja këtë po ua them unë. Këtë ndoshta do ta dëgjosh dikush por prandaj çdo gjë hapur po e flas.

Dhe tani po vijnë njerëzit, dikush nuk ka para, e njerëzit e dijnë, të gjithë më njohin sepse jam personalitet publik, kam qenë politikan i madh dhe ata e dijnë kush jam. Tash këtu në dyqan të vogël kur hyj fëmija i vogël më shikon, më njeh. (qesh) E shoh unë nuk ka, nuk ka, unë i mbush qeset i them, "Merre" (qesh) Spinaq, nuk e di çka ka pasur. Dikush nuk ka mjaft, unë shtoja. Erdhi Adem Demaçi, e këta të mijtë po thonë, "Ja Adem Demaçi." E di, e urrejnë, nuk bën, unë them, "Dëgjo, një qime nuk guxon t'i mungoj njeriut." Unë kam qenë aty drejtor..

Erdhi Ademi, ishte maskuar {vë dorën në kokë} (qesh). Shetit aty, asgjë dhe kështu, dhe unë jam aty, unë aty jam treguar në fakt, unë si njeri por edhe kompania ime. Unë si njeri në fakt kam treguar se si jam, kur të gjithë kanë urrejtur apo nuk kanë urrejtur, kur shumë kanë urrejtur, i kanë fajësuar shqiptarët për çdo gjë që po ndodhte, unë mbledh forcat kur më sulmonin këta eksremistët serbë që të ju ndihmoj. Në timen, në hyrjen time unë kam apsur shqiptarë, cigare, bukë, gjithmonë kur vija i sillja. Atë që e kanë kërkuar, gjithmonë e kam sjellë, gjithmonë, gjithmonë, gjithmonë, gjithmonë.

Një ditë unë vij nga puna, të gjithë kanë dal jashtë. Çka u bë? Policia, paramilitarët kanë ardhur dhe i kanë detyruar të ikin. Unë të gjithë i kthej brenda. Kemi hapësirë të përbashkët, uleshim aty, binim dakord, dhe kështu. Gjithmonë kam ndihmuar, gjithmonë kam ndihmuar. Emë tutje është një familje, aty për pak jam vvarë. Një familje nga, nga atje rruga e Proleterit, nuk është e rëndësishme tani, nuk dua ta emëroj. Kur kanë ardhur të më lusin të ju ndihmoj. Unë kam shkuar në mbrëmje të merremi vesh që herët në mëngjes të nisemi {lëviz dorën} të shkojmë për Fushë Kosovë. Këtë kurrë nuk do ta harroj. Pasi që ata kanë qenë më shumë, unë e thirra edhe një [njeri].

Kur unë kam hyrë në atë shtëpinë atje, në atë odën, gjithë fëmijët e vegjël më shikojnë si të isha Zot. Duhet nesër ta lëshojnë shtëpinë, të shkojnë. Unë i them këtij njeriu, “Mos shko bre, asgjë nuk do të bëhet, qëndro.” Unë nuk e di nëse i nxjerr jashtë dhe ju ndodh ndonjë gjë, nuk di çfarë të bëj. Dhe unë mbledh guximin dhe në, e pikat në Fushë Kosovë {tregon drejtimin}, pikat, por njerëzit më, pasi që më kanë, e kam qenë i njohur kam qenë kundërshtar i Millosheviqit, unë nga kjo jam frikësuar. Që, ja ku është ky kundër Millosheviqit, por ata jërzit që i kam takuar aty nuk kanë qenë kundër meje dhe vetëm kanë dhënë leje. Dhe kështu i kam dërguar, disa familje deri atje. Më tutje...

Erëmirë Krasniqi: Tek treni apo ku?

Momçillo Trajković: Deri te treni, deri te stacioni, deri te stacioni. Ja një shembull, ai njeriu ka vdekur tani. Ai ka qenë sekretar në, e nëse, Emrush është quajtur në Ramiz Sadik. Në pazar kur ka ardhur, nuk ka pasur para. As nuk ka kërkuar, sepse kam qenë, koleg i imi, jurist, kemi qenë, unë, unë e shoh që “A ke nevoj për para?” Unë atij i jepi një mijë e treqind marka, atëherë kanë qenë, kanë qenë markat. Një mijë e treqind marka i’a kam dhënë aty në treg {tregon me dorë sikur jep}. Të shkoj, të, të jetoj.

[Intervista ndërpritet për shkak të problemeve teknike]

Lufta ka kaluar, unë me familje kam jetuar në Mimosë {tregon drejtimin} kjo është përballë Qendrës për Media, a e dini ku është Qendra për Media?

Erëmirë Krasniqi: Po.

Momçillo Trajković: Përballë është ai, ka qenë një, një motel aty, e kemi blerë privatisht atë dhe aty kemi jetuar me familjen. Restoranti, punonim, e mbanim atë restorantin, ai ka qenë i vetmi restorant serb atëherë. Sidomos për shkak se këto shqiptare, nuk kanë mbajtur mish derri, atëherë të huajt vinin aty, kur kanë qenë. Shumë mirë kemi punuar. Dhe unë, pas luftës, më 31 tetor në vitin ‘99 jam sulmuar në banesën time. Më kanë qëlluar dhe më kanë plagosur, në këtë këmbë [e djethta] këtu. Ka ardhur, kjo është, më kujtohet që jam shtrirë, e dëgjoja Evropën e Lirë e para kësaj kam qenë në Beograd.

[Intervista ndërpritet për shkak të problemeve teknike]

Dhe unë një natë, ditë përpara asaj kam qenë në Beograd. Dhe më thirr mua fqinji, dhe më thotë, “Ta kanë thyer banesën mbrëmë.” dhe “Eja.” Unë nga Beogradi po vij, kur kam ardhur me këtë, ka qenë aty KFOR-i, pasi që qelësi ka qenë tek ata. E kam parë që ma kanë shkëputur telefonin, dhe asgjë nuk kanë marrë. Pra kanë pasur çka të marrin, asgjë nuk kanë marr. Vetëm telefonin e kanë shkëputur.

Erëmirë Krasniqi: Ajo banesa në Dardani?

Momçillo Trajković: Ajo banesë në Dardani. Dhe unë shkoj atje, kur kam shkuar ta marr qelësin e banesës, të gjithë dëshironin, të ishin aty. Unë them nuk ka nevoj. Unë kthehem në banesë dhe diku kah ora pesëmbëdhjetë në njëmbëdhjetë në mbrëmje dikush cingron... Dhe unë, Pasi që kam apsur dyer dyshe si këto {tregon me dorë drejtimin} dyer, pastaj korridori im pastaj dera tjetër dhe atje ajo dera e hyrjes. Dhe tamam kam ardhur e kam ndezur dritën. Kur e kam ndezur dritën, përnjëherë ka gjuajtur. Dhe përmes xhamit, i kam fotografitë, direkt ka shënjestruar këtu {tregon zemrën e vet}.

Por ka qenë një armaturë, e cila e ka ndaluar plumbin dhe plumbi ka fituar rikoshet dhe përfundon këtu te unë {tregon këmbën e djathtë}. Dhe unë bie, dhe bërtas, dhe ata kanë menduar që më kanë vrrarë. Dhe kanë shkuar poshtë, përpara ma kanë prishur veturën, xhamin e përparmë dhe kanë shkuar.

Erëmirë Krasniqi: A ju kanë kërcënuar?

Momçillo Trajković: Jo, jo, kurrë asgjë, kurrë unë asgjë s’kam pasur dhe pastaj, më kujthet kjo vetëm kur, kur kam rënë, dhe pres kur do të hyjnë brenda të më përfundojnë. Këtë, këtë kurrë nuk do ta harroj. E pastaj unë jam zvarritur, pasi që kam qenë i plagosur. Jam zvarritur deri në dhomën e fjetjes, përfundi jastëkut e kam pasur revolen, revole për zonja, e gruas, {tregon me dorë madhësinë} revole e vogël. Tani po e marr atë revolen dhe po pres që ata të hyjnë dhe po shkoj deri te telefoni. Por pasi që një ditë para kësaj ma kanë shkëputur telefonin, unë kam, fqinja e cila ma ka dhënë telefonin tjetër, jo digjital por por ai {tregon dhe e kthen numratorin në ajër} i cili kthehet. E ata nga KFOR-i ma kanë dhënë telefonin nëse ka nevj, t’i thërras. Nga frika nuk mund t’ia qëlloj, nuk mund numrin, njërin që e kam qëlluar, i thërras ata, ju them. Pas tre minuatve çdo gjë ka qenë {hap duart} e kaltër.

Ka qenë gjithçka e rrethuar, e dinë. Dhe kështu përfundon kjo, dhe tani pasi që unë kam kaluar të jetoj aty, po vjen, po vjen, ata e kanë detyruar një shqiptar, sot e kam mik të madh. Të pyes çka, si jam sjellë unë në kohën e luftës. SHIK-u i ka dhënë detyrë. Ai ka shkuar, së pari unë kam qenë i dyshuar për vrasjen e Rrahman Morinës, nuk e di a keni dëgjuar për këtë. Po. Ka qenë emision special, këtu e kemi xhiruar emisionin {tregon vendin}, ka qenë ai emisioni “Rrahman - Tradhtar i madh” nuk e di. A e keni shikuar atë emision? Po, po, ka qenë emisioni, unë mendoj “Koha”, “Koha” e ka bërë atë apo nuk e di kush e ka bërë. Sepse unë kam qenë i pranishëm kur Rrahmani ka vdekur. Rrahmani ka vdekur në një seancë ku ka kryesuar. E kam fotografinë një orë para se të vdiste Rrahman Morina. Atë e kam treguar, ata të gjithë kanë xhiruar. Dhe krahas të gjithave...

Erëmirë Krasniqi: Ai ka vdekur prej zembrës?

Momçillo Trajković: Pej zembrës, prej zembrës ka vdekur por për, në tavilnat e kryesuesve, kemi video inçizim për vdekjen e tij. Por pasi që unë atëherë kam qenë i njohur, i popullarizuar, shqiptarët më kanë dashur për shkak të politikës të cilën e kam pasur dhe ata mua, më kujtohet, unë pastaj kur ka vdekur, unë kam shkuar të shoh. Nuk e kam ditur, unë te Rrahmani kam ardhur pas tre sekondave. Emergjencia e ka dërguar e unë kam shkuar ta shoh, deri në spital të shoh çka u bë me të.

Por, mbërrij në spital. Unë kam mednuar që është në interno dhe aty ka qenë mjeku Faik Hima. Pastaj ai këtë e ka demantuar pak, është frikësuar njeriu e dini. Kur kalon koha atëherë i'a përshtat vetës si të përshtatet më shumë (qesh). Dhe Faiku ka qenë mjek kujdestar dhe kur më ka parë mua, si jam dukur, më tha, "Njeri, shtriju aty. Lëre Rrahmanin, qfarë Rrahmani, ti ke mbaruar."

E atëherë, në atë kohë nga Beo, nga Beogradi kanë arritur mjekët nga Beogradi për ta marrë përsipër spitalin. Dhe kur kanë dëgjuar që unë jam i sëmurë, pasi që kam qenë nënkryetar i Qeverisë së Serbisë, në mënyrë emergjente ekipi vjen tek unë. E shtynë ata Faikun {lëviz dorën} sikur të mos ekzistonte (hap duart, qesh). Më kontrolluan dhe unë tani po i pyes, "Kush është kujdestar këtu?" Pasi kam qenë njeri i fuqishëm, unë tash mund të thoja çfarë doja. Thotë, "Doktor Faik." Them, "Doktor Faik Hima tek unë." Mua më vinte keq, unë jam kësi njeri, më kupton, si Faik Hima tash ta shtyejnë atë.

Dhe gjithë natën ka qenë kujdestar Faik Hima aty ku kam qenë unë. Në mëngjes më kanë dërguar në, në VMA me helikopter kam shkuar në mëngjes. Dhe atëherë, ai ka qenë tek Faik Hima, ka qenë tek këta në Prugovc, tek ky dëgjon për këtë paratë të cilit i'a kam dhënë, i ka vizituar të gjithë të merr vesh se si jam sjellë unë gjatë kohës së luftës. Dhe kur ka pyetur për të gjitha këto, herën e fundit ka qenë në Prugovc tek ai Dragusha, kur i ka treguar çka është dhe si është.

Ai ka ardhur tek unë atje te ajo Mimoza dhe më ka thënë, "Duhet të të them diçka, ti je njeriu që e kam urrejtur më së shumti, deri sot. Më duhet të të them se tani të respektoj. Më fal për të gjitha të këqijat që i kam menduar për ty." Ai shqiptari më thotë mua këto. Dhe pas kësaj ne bëhemi, sot jemi miq, (qesh) sot jemi miq. E kjo është, nuk e di, Naim Breznicën, a e dini Naim Breznicën?

Erëmirë Krasniqi: Jo.

Momçillo Trajković: Ai mban, punon në Fushë Kosovë. (qesh) Dhe tani ai, ai na thërret "komandant", unë atë e thërras "komandant". (qesh) Unë komandant i gardës serbe, e ai i gardës shqiptare. Ai ka ngrënë rrahje të pabesueshme gjatë kohës së luftës. Ai më ka treguar për këtë. Fqinji i parë e ka rrahur. Kur e ka rrahur i'a ka shpëtuar edhe jetën. Ai ka punuar në një, me Demaqin në komitetin e Helsinkit dhe me profesorin, si quhet, ja kam harruar, miq të mirë jemi, ka vdekur edhe ai. Ka qenë kryetar, jo jo, tjetri. Ka qenë kryetar i Komitetit të Helsinkit.

Kaltrina Krasniqi: Kush është ai?

Momçillo Trajković: Ka qenë...

Erëmirë Krasniqi: Mark Krasniqi?

Momçillo Trajković: Ka vdekur. Ja nuk po më kujtohet.

Kaltrina Krasniqi: A është Mark Krasniqi?

Momçillo Trajković: Jo Marku, jo, jo, jo.

Kaltrina Krasniqi: Nuk është Marku.

Momçillo Trajković: Ka qenë nënkryetar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, më herët ka qenë politikan. Ka vdekur para disa vitesh. Para Demaqit. Dhe ata e kapin atë, një grup të atyre aktivistëve, policia serbe dhe e marrin, i dërgojnë. Dhe ky fqinji e kupton, polici e vëren Naimin. Fqinji kur, një dritë {i qon duart lartë} ka qenë, një banderë, dritë. “Kur ka filluar të më rrah” thotë. “Më rrah, më shuton, më shuton, më shtyn në terr, dhe më rrah ende.” (qesh) Thotë “Tash më rrah.” Thotë “Hup.” Thotë, dhe është dashur ta rrah në mënyrë që ta shtyej në terr që ky të ikte. Dhe kështu, kështu e ka nxjerrë njeriun, shiko.

Kështu e ka shpëtuar njeriun, {lëviz dorën} i’a ka shpëtuar jetën. Këta të tjerët i kanë vrarë. Është e tmerrshme, që Naimi, unë kam... Kur ka qenë 2009, kur ka qenë kjo pavarësia, në vitin 2009 ka qenë? Apo 2008?

Erëmirë Krasniqi: Tetë [2008].

Momçillo Trajković: Vitin e tetë. Më thirr ai, “Hajde,” thotë “eja tek unë të të qeras për republikë.” Unë i them, “Nuk kam kohë.” i them, “Nuk kam kohë tani.” unë i them atij. “Jo, në rregull” thotë, “por të pres të vish tek unë.” Pastaj unë e kam xhiruar një intervistë me një gazetar të njohur, xhiruesin nga Beogradi, Sllaven Kranjc. Ai ka vdekur. Dhe kur e kemi xhiruar atë emision, po kalojmë nga Fushë Kosova dhe mua më kujtohet Naimi.

E thërras unë atë në telefon, “Ku je?” Jo, nuk e thërras por ai më dërgon mesazh, e dini atë, kur shqiptari flet serbisht, {me duar simulon shkrimin e porosisë} i bën disa gabime, (qesh) katastrofë gramatike dhe unë tani, ky po inçizon, unë po e lexoj atë mesazhin - “Të vish të të qaros për Republikën e Kosovës” thotë. Ai mua më ka dërguar para kësaj. Dhe unë lexoj, ky inçizon, po shkojmë tek ai. Dhe drejt atje në radio, e ka radion, K Radio.

Atje në Fushë Kosovë, pas një, më kujtohet ku është ajo, i pyes disa fëmijë të vegjël në gjuhën shqipe, kuptohemi ne, ata më dërgojnë drejt tek ai. Dhe cingroj unë në derë {me dorë tregon sikur cingron} të radios. Tri herë. “Kush është? Pyet ai. “Dëgjo” ju them atyre, “kur dikush cingron tri here, ta dish që serbi po vjen.” (qesh)

Erëmirë Krasniqi: (qesh)

Momçillo Trajković: Ka, e gjithë kjo, e gjithë ajo është xhiruar. Ai hap, (britmë) e kur e ka parë kamerën. U puthëm ne aty a e dinë. “Ndale, ndale.” ‘Hajt i mbyllim ne të gjitha aty, ulemi. Unë i them atij, “A dëshiron ta xhirojmë këtë, që unë dhe ti të flasim?” “Fol çfarë të duash ti e di që unë jam miku yt. Që asnjë fjalë nuk do ta heq. Çka do që dëshiron, fol.” Dhe e fillojmë ne bisedën. “E si e ke tani, ti, Naim?” I shikoj të gjithë flamujt shqiptarë, “Ku e ke Republikën e Kosovës? Nuk ke flamur. Ke shtet, nuk ke flamur.”

E thotë, “Kemi festuar” thotë, “shumë e nuk kemi arritur por tani do t’i bëjmë” thotë, “flamujt.” Dhe ai fillon të flas për të, e aq mirë ka folur, që serbët të cilët nuk kanë pasur shumë gjëra të qarta, unë me qëllim e kam lënë, që të sqarohen.

Pas dy ditësh, koment {simulon shkrimin me dorë} në, a është, cila gazetë ka qenë, a ka qenë *Blic* nuk e di, beogradase. Titulli, “Miku ynë Naim” titull, në gazetën serbe. Dhe shpjegon çfarë ka thënë Naimi {lëviz duart}, si ka thënë, tash një. E në fund t’i jepim mirënjohje edhe zotëri Trajkovićit, i cili ka ka mbajtur leksion shumë gazetarëve si udhëhiqet një bisedë. (qesh) Kështu që kjo ka qenë me të vërtetë, me të vërtetë e bukur. Dhe për çka kemi filluar të, para kësaj prandaj kemi ardhur, e këto para, ky që i ka dhënë, të cilit unë i kam dhënë para.

Dhe unë kam, pasi që kanë gjuajtur në mua, unë është dashur që pas kësaj, si të, nuk kam mundur më aty, në atë {hap duart} banesë të jetoj. Dhe unë vij, i kam apsur fqinjët e mirë por aq ishin të mirë sa që, atëherë shumë serb janë shantazhuar, përse kanë shitur banesa. Ai njeriu ka ardhur tek unë, aty te Mimoza. Dhe më ka thënë që dëshiron ta blej banesën. Banesën time, sa po e shes, unë i’a kam shitur atij abnesën, sot nuk do të mund të. Njëqind e njëzet e pesë mijë marka atëherë, atëherë në vitin 2000. Njëqind e njëzet e pesë mijë marka, kjo është tani njëqind e njëzet e pesë mijë euro, kështu vjen, pa marrë parasysh {lëviz duart}. Ai shkon ta bëj kontratën të një avokat në Prishtinë.

Dhe shkon, unë i’a kam dhënë letërnjoftimin, që t’i rregulloj të gjitha. Dhe kur ky avokati e ka parë, i thotë, “Ani, ani mirë ke bërë çdo gjë” thotë, “Atë bërlllogun ta largojmë nga Kosova.” Ky i ka thënë fqiu tim shqiptarë, ky avokati shqiptar, mirë “E dinë, falemnderit prej Zotit ta heqim, atë atë bërlllogun.” thotë. Ndërsa aty ka qenë ulur ai njeriu të cilit unë i kam dhënë para, i cili ka punuar me të. “E ku është” thotë, “Moma Trajković?” Thotë, “Në Çagllavicë.” Dhe i ka thënë këtij “Mos fol ashtu.” thotë. Dhe ata tregojnë si i kam dhënë unë para dhe dëshiron të më gjej për të mi kthyer paratë.

Mund ta paramendosh çfarë rastësie? (qesh) Pastaj vijnë të gjithë së bashku tek unë, ky vjen, dhe mua mi kthen paratë, mi jep paratë. As nuk i'a kam kërkuar. Mi jep paratë dhe ky, ky shqiptari që ka thënë ashtu, më ka kërkuar falje, e dinë. Pra vet, astaj është një, një Avdi nga Rugova, të cilin e kam takuar në rrugë, e kam njohur. Ai është miku i mirë i Selimit. Unë them, "Avdi, a ke nevoj për para, a po të nevojiten paratë?" Thotë, "Falemnderit." Dhe këtë e tregon në çdo vend tani. E Selimi, ai qeni, nuk ka dashur të lajmrohet(qesh).

Unë e kam thirr, nisem për ta thirr në shtëpi, dhe them, mos dashtë Zoti që diçka t'i ndodh, e dinë si është. Që mua. Pastaj e thërras Avdinë. "Më trego Avdi, që, ku është Selimi, çfarë duhet të bëj, çka duhet t'i ndihmoj?" Ai nuk më është lajmëruar kurrë. Pas luftës jemi takuar, ai ka qenë gjykatës. Edhe pas luftës jemi takuar edhe tani, para disa dite jemi parë, edhe tani jemi të mirë, e dinë (qesh).

Erëmirë Krasniqi: (qesh)

Momçillo Trajkoviç: Kështu që i kam ato, ato, janë miqësi të sprovuara.

Kaltrina Krasniqi: Më thoni si ka qenë jeta juaj këtu 19 vitet e fundit, pas pavarësisë, po mendoj pas luftës?

Momçillo Trajkoviç: Paj i vështirë, i vështirë. Unë kam, unë kam, unë dhe ipeshkvi Artemije kemi mbetur të vetmit prej atyre njerëzve të rëndësishëm, që kanë qenë diçka për këtë popull, të gjithë të tjerët kanë ikur. Unë e kam rezikuar jetën, fillimisht për atë. Unë edhe sot e kësaj dite i shoh komentet, njerëzit shajnë e dinë, kur shohin diku diçka unë po them, disa shqiptarë, nuk është, ka, sikur që dikush është serb, ka budallenj të ndryshëm gjithkund. Mendoj që mund njeriu qimen, kokën ta humb. Por e kam tejkualuar atë kohë. Fillimisht, unë kam marrë vendim të qëndroj, pastaj ne, ipeshkvi dhe unë e kemi shpëtuar këtë Kosovën qendrore sepse ne atëherë kemi bashkëpunuar me Xheksonin dhe falë tij ne i kemi mbajtur ata njerëzit që janë përgatitur të ikin. Kemi qenë në vendin e ngjarjes dhe kështu kemi, kështu e kemi mbajtur Kosovën qendrore.

Pastaj, unë jam serbi i parë që ka folur me Thaçin dhe Ramushin dhe me Qosiqin dhe me këtë, Ibrahim Rugovën dhe me Veton Surroin. Unë jam me Vetonin përndryshe i mirë, prej më herët. Unë jam, për shembull, kur e kam mbajtur atë kioskën, kemi shitur gazeta, atëherë ka qenë shtypi i opozitës. Dhe në këtë moment, tani të ju them, shtypi i opozitës, serbe jo shqiptare dhe njerëzit aty çdo ditë blejnë gazeta.

Dhe një ditë vjen Vetoni tek unë, "Momo", më thotë, "Të pyes diçka, sikur të të lutesha a do e bëje?" "Çka?" Thotë, "Unë po e publikoj një gazetë të re, Koha Ditore, a do e shisje këtu?". E di në atë kohë serbët, njeri ata, unë atë Telegraf Quvurija që e ka publikuar nuk kam guxuar ta shes e jo më ta shes. Unë kam shitur apo jo. I them atij, "Ma sjell nesër në mëngjes." Pyetne Vetonin. Dhe e sjell Vetoni, dhe

kështu për herë të parë ka ardhur ajo Koha Ditore shtypi shqiptar në, në kioskë, tek unë. Dhe aty kemi filluar, unë e kam shitur atë. Kur unë kam dashur të publikoj gazetë, një gazetë Nacional, kemi përgatitur çdo gjë dhe unë kur kam pyetur, pasi që Vetoni e ka shtypshkronjën, e kam pyetur atë që ta shtyp.

Më ta, “Ma sill pa.” Atëherë njejtë ka qenë në atë kohë, thotë, “Pa kurrfarë problemi, nuk ka problem për pagesë, ma sill, unë do ta shtyp.” Por, ne pastaj kemi hequr dorë. Pra, atëherë unë kam siguruar që Koha Ditore të del për herë të parë në kioskë, në qendër të Prishtinës, atë Vetoni, për këtë, të gjithë e dijnë. Vijnë njerëzit për të blerë gazeta.

Pjesa e Pestë

Momçillo Trajković: Pastaj, me dy, me dy, me dy korrik të vitit ‘99 atëherë ka qenë de Melo shef i UNMIK-ut, i dërguari i parë, de Melo ai që u vra në Bagdad.

Erëmirë Krasniqi: Po, ai i pari për kohë të shkurtër.

Momçillo Trajković: Po, po, shkurt ka qenë. Ai ka ardhur tek unë dhe ipeshkvi dhe na ka lutur ta pranojmë bisedën me shqiptarët. Gjatë kemi menduar dhe në fund kemi rënë dakord. Ne kemi kesi, [Erëmirë hyn në kadër] kemi rënë dakord të hyjmë në qeverinë e UNMIK-ut, KPAK si është quajtur atëherë - Këshilli i Përkohshëm Administrativ i Kosovës. Atëherë kryetari i parë ka qenë de Melo. Dhe në shtëpinë e ushtrisë {me kokë tregon drejtimin} atje te Grandi, aty kemi pasur bisedë.

Ajo bisedë ka zgjatur shtatë orë, që ta jepin atë deklaratën {ngreh duart} deklaratën e famshme të përbashkët të atëhershme. Unë atëherë i shtrëngova dorën Thaçit, pastaj më sulmonin në Beograd, çdo mbrëmje në ditar më kanë paraqitur si tradhtar. “Ja tradhtari” dhe kështu. Pastaj kam hyrë me ipeshkvin kam hyrë në Qeveri. Thaçi, {i numëron me gishta} Rugova, Ramushi nuk ka qenë, Qosja, Veton Surroi, ipeshkvi dhe unë, dhe nuk e di kush ka qenë, dikush aty.

Ne kemi qenë qeveria e parë e Kosovës. Por ata kanë qenë, nuk kanë qenë fer. Jo ata nuk kanë qenë fer, ata qëllimin e vet e neve kanë dashur të na keqpërdorin. Por unë jam ujk i vjetër, nuk mundesh të, mund ta pranosh unë e di. Pastaj ne e kemi lënë atë KPAK-në, ipeshkvi dhe unë në mënyrë demonstrative. Atëherë kur po i krijonin Trupat Mbrojtëse. Ata, ata e kanë bërë këtë, neve as nuk na kanë pyetur, Kushneri me shqiptarët e kanë bërë, e neve na ka sjellë tani në senacën e shtatë “Ja”. Dhe ne kemi refuzuar, e kemi lënë KPAK-në. Pastaj kur ka ardhur Klintoni, ka kërkuar të bisedoj me mua dhe me ipeshkvin.

Dhe ne kemi biseduar me Klintonin, kemi biseduar dhe atëherë njoftohemi me, me të bijën, bija e tij ka qenë Qells, ajo e tija. Kjo, Ollbrajt, Kushneri, në biseda ka marrë pjesë {numëron me gishta} Vetoni, Rugova, Thaçi. Eh kjo, partia e tyre, ata edhe kanë folur.

Erëmirë Krasniqi: Në cilin vit ka qenë kjo?

Momçillo Trajković: Kjo ka qenë në vitin '99 të muajit nëntor.

Erëmirë Krasniqi: Kjo ka qenë një muaj pas... tuaj?

Momçillo Trajković: Po, unë atëherë kam qenë i plagosur, e dini. Pastaj më kanë, de Melo më ka dërguar nga, nga Timori më ka dërguar kësi, telegram mbështetës. Pastaj Volebek më ka dërguar telegram, "Pse e keni gjuajtur njeriun që dëshiron paqe? Shikoni, të vetmit njerëz që kanë pranuar, që të flasin me juve, ju i gjuani, dëshironi t'i vrisni njerëzit." E dini dhe kështu, është në librin tim, janë të gjitha. Pastaj kemi biseduar. I pari ka folur Surroi, njeri shumë i mençur.

Ai është njëri prej njerëzve më të mençur, shumë e kuptueshme. Pastaj është lajmruar të flas Thaçi. Dhe afërsisht, "Ne, zotëri presidenti Klinton, ne kësi, ne e mundëm armikun tonë të përbashkët" Kinse Amerika dhe Kosova, e kanë mundur Serbinë e dini, në atë kuptim. E përderisa ky fliste kështu, unë e kam pasur broshurën për manastirët, manastirët e shkatërruar. Atë e kam pasur të vetmen, e nxjerr nga çanta unë dhe {afro dorën sikur jep} i'a jap Klintonit. Përndryshe sa, unë jam ulur këtu, ipeshkvi aty dhe Klintoni ka qenë aty, në një metër. Kështu jemi ulur. Unë them, "Urdhëroni zotëri president, shikoni këtë."

Dhe tani deri sa Thaçi po flet, ky po shikon. Pastaj goditi me dorë, unë atë, atë deklaratë e kam dhënë menjëherë pas, pas asaj bisede. Por nuk kam parë që, që mediat shqiptare kanë raportuar, ato serbe po. Kur, deri sa ky Thaçi ka biseduar, Klintoni ka {e ul grushtin} lgodit me dorë tavolinën dhe thotë, "Pusho. Pse flet për këtë, ti mendon që mua më pëlqen të dëgjoj?" I thotë Klintoni Thaçit. Ky u ndal. Dhe po i shikon ato fotografitë e rënimeve. "Po të pyes unë ty, po ju pys unë juve, nëse Amerika jep para që e gjithë kjo të rindërtohet, a do t'i shkatërrojnë prapë?" Pastaj ndërhyt Rugova, "Zotëri president, ato janë të Millosheviqit, kishat, manastirët e Millosheviqit."

E ipeshkvi Artemije e ka sjell një libër të madh, e dini kisha ortodokse i ka ato dhurimet, dhe thotë, "Zotëri president, këta janë manastirët ngashekulli dymbëdhjetë, trembëdhjetë-katërbëdhjetë siç e dini Millosheviqi atëherë nuk ka qenë i gjallë." E dini, dhe atë nuk dëshiron, dhe atëherë nuk kemi pranuar, ne atëherë nuk kemi pranuar. Atëherë na kanë thyer, pas kësaj, sepse unë kam qenë problem, na kanë thyer ipeshkvin dhe mua. Atë tandem e kanë sjellë edhe Rada Trajkovićin, në vend meje ka ardhur Rada Trajković. Dhe NATO më tutje, ka vazhduar. Dhe pastaj kemi, kemi arritur që këtë ta ndalojmë pra, atëherë i kemi vizituar shumë, shumë, shumë, shumë serb që kanë qenë nëpër banesa.

Kjo është diçka më pikëlluese që kam parë. Më, më, më të palumtur, unë e di që ka pasur tragjedi edhe nga ana tjetër, e di, e di si kanë mundur idiotët të sillen me shqiptarët. Por këtë nuk e kam parë, unë mund të supozoj dhe nuk dyshoj në këtë. Por atë që e kam parë, situata të ndryshme, për shembull, i biri ka ikur në Beograd, e ka lënë babain dhe nënën përball, tek Shtëpia e Shëndetit diku në Prishtinë, {tregon drejtimin} aty. Dhe mua më thërret që unë të shkoj t'i vizitoj, t'i shoh. Dhe them, "Njeri, do të më vrasin." "E çka je pra..." Dhe them, "Njeri, ti ke ikur, e ke lënë babain dhe nënën, e ke shpëtuar kokën, unë duhet të..."

Por unë them jo, por prapë nuk kam duruar. Dhe unë nisem, me kushtet më të rënda mbrij deri te ata atje. Më tutje, plaku dhe plaka, lart, {tregon drejtimin} sipër ku ka jetuar Veli Deva. E kanë pasur një banor serb, i cili aty ka jetuar dhe ka pasur armë dhe ato armë i ka futur në termo ngrohjen. (qesh) Dhe ka ikur, ka shkuar, dhe e ka lënë plakun dhe plakën. E këndej këta shqiptarët e kanë sulmuar shtëpinë, t'ia marrin shtëpinë. E ai nuk di çfarë të bëj, Dhe na thirr dhe thotë, ne shkojmë ta takojmë dhe ai thotë nuk e di çka, "Unë nuk mund të duroj më por edhe nëse e shohin këtë," thotë, "Edhe nëse vijnë dhe i shohin këto armë në termo, çfarë do të bëj?"

Pastaj ne i themi KFOR-it, ju shpjegojmë situatën sepse ata i tërheqin për t'i arrestuar, nuk shikojnë. Dhe pastaj kur e qëlluan profesorin përmes derës, njejtë, shumë, shumë raste. Dërgonim pako në këtë rrugën përball MPB-së, ku është MPB tani, ku ka qenë më herët. Aty njejtë, shumë njerëz kanë pësuar. Kemi hasur në njerëz të vdekur, është e tmerrshme. Është e tmerrshme. Por banesat, ka në librin tim është kjo, kur Kushneri, unë, at Sava Janjiq dhe Thaçi i vizitonim banesat prej të cilave serbët i kanë dëbuar. Dhe pastaj shkojmë atje, ah. Dhe tani Thaçi, pajtohet me ne deri sa janë me neve, Kushneri, gazetarët, kamerat inçizojnë gjithçka.

Sapo e kthejnë shpinën, ai kthehet dhe thotë "Mos u shpërngul tani, qëndro këtu". Këtij që ka hyrë brenda, ai ka humbur, tani ai po justifikohet që ka humbur, i'a kanë djegur shtëpinë, ata ndoshta ta kanë djegur shtëpinë por unë nuk ta kam djegur shtëpinë, unë. Por atëherë njerëzit kanë mbetur pa, pastaj, kcejnë në mua, dëshirojnë të më vrasin aty para Kushnerit, para të gjithëve e dini. Por unë i kam duruar të gjitha këto, i kam duruar të gjitha. Ka pasur shumë, shumë, shumë probleme, ajo ka qenë e vështirë. Onda sam ja, onda sam ja krenuo da vidim, ja znam da u Beogradu treba da se menja politika, da bi se nešto radilo.

Pastaj unë kthehm prapë në politikë. {kruan kokën} Dhe në vitin 2000 unë hyj në DOS. Keni dëgjuar për DOS, a keni dëgjuar për DOS? Unë kam qenë antar i kryesisë. I vetmi, i vetmi njeri nga Kosova i cili ka qenë në DOS me Gjingjiqin, unë kam qenë. Ajo lëvizja ime SPOT, si është quajtur, Srpski Pokret Otpora [Lëvizja e Rezistencës Serbe] lëvizje demokrate, kështu është quajtur dhe unë atëherë kam qenë me Gjingjiqin. Atëherë jam bërë kryetar i Komitetit Federal për bashkëpunim me UNMIK-un dhe KFOR-in, para Jugosllavisë atëherë. Unë kam qenë kryesori, dhe atëherë kam, pastah Sollana ka kërkuar nga unë ndërrime, ta sjellin Çoviqin.

Dhe atëherë Çoviq ka ardhur në vend meje, Gjingjiq më ka thirr, Gjingjiq ka qenë për mua, ai nuk e ka dashur fare Çoviqin por ky e kërkon, pasi që ka punuar jugu i Serbisë, pasi që atë politikë e ka bashkuar me qëllim që ta merr përsipër Kosovën. Pastaj Çoviq, Çoviq e ka marrë përsipër Kosovën. Dhe aty kam pasur përplasje me Çoviqin, atëherë me Millosheviqin pastaj me Millosheviqin e vogël, Çoviq ka qenë Millosheviqi i vogël. Pastaj përplasje edhe me të dhe kështu unë gjithmonë me përplasje, dhe aty kam pasur jetëgjatësi të shkurtër. Në kohën e Millosheviqit kam, unë kam qenë nënkryetar i Qeverisë vetëm njëmbëdhjetë muaj e për këtu, në këtë, për bashkëpunimin me Qeverinë Federale nuk kam qenë sa, pesë-gjashtë muaj, kam pasur përplasje me Çoviqin.

Dhe pastaj por Çoviqi ka qenë bashkëpunues me këta, çka me Sollanën, dhe Sollana ka kërkuar që mua të më heqin dhe që Çoviqi të merr përsipër, ta merr përsipër Kosovën. Dhe Çoviq në vend meje e ka marr Kosovën. Pastaj unë kam qenë deputet i popullit në Kuvend kësi, i Serbisë deri në vitin dy mijë, deri në vitin dy mijë e tre pastaj kanë ardhur zgjedhjet dhe Gjingjiqin e kanë vrarë. Unë me Gjingjiqin atëherë kam qenë i afërt, ne kemi diçka ashtu, kur e ka bërë programin e vet në Kosovë unë kam qenë bashkëpuntor i tij. Pikërisht këtë po e shikoj, të ju tregoj fotografinë, kështu dhe njeriu i vrarë. Pas kësaj DOS e ka përfunduar misionin. Unë jam tërhequr dhe nuk kam hyrë më në politikë, nuk jam marrë me politikë.

Erëmirë Krasniqi: A jeni kthyer këtu?

Momçillo Trajkoviq: Këtu. Po jo, atje sa kam qenë, kam qenë lart në Kosovë. Unë kurrë nuk jam larguar nga Kosova, kurrë. Kurrë nuk jam. {merr kabllon}

Erëmirë Krasniqi: E me çka po merreni tani ?

Momçillo Trajkoviq: Tani, tani e kam një zyre për çështje ligjore. Nuk është avokaturë klasike. I kam disa bashkëpunëtorë aty dhe punojmë çështje ligjore, çdo gjë që është, dhe avokaturë, bëjmë punë avokati. Edhe këtë e bëjmë. Punoj mjaft, tani punoj me pensione në Beograd, me këta nga Kosova. Dhe aty kam bërë shumë miq shqiptarë, me të shumtë, rreth 500 pensione unë ju kam zgjidhur njerëzve. Dhe kështu, përndryshe jam në pension, në pension jam, e kam pensionin tim, i kam 65 vjet, po. Kështu që unë kam gjetur çfarë të bëj. Merrem nga pak me këngë. Unë mundohem ta hulumtoj atë këngën serbe kosovare. Dhe pastaj e, e gjej unë atë, bëj aranzhimin e ri dhe i inçizoj.

Erëmirë Krasniqi: A mund të flisni rreth karrierës tuaj kur keni qenë i ri, jeni marrë me muzikë, keni qenë në akordet e Kosovës, e gjithë kjo?

Momçillo Trajkoviq: Kam qenë, ja kjo fotografi është nga Akordet e Kosovës. Po, ajo fotografi është nga Akordet e Kosovës. Shumë, unë kam punuar në Këshillin Ekzekutiv të Kosovës, kam punuar në sekretariatit për punë pra, sot ajo është Ministria e Punës, kam punuar me punësimin e punëtorëve jashtë vendit. Dmth këtë punë kam pasur. Dhe unë bashkë me Refik Agajën, Refik Agaje një diplomat,

nuk di a është i gjallë, mendoj që ende është i gjallë. I moshuar është tani, ndoshta i ka afër 90 vjet, deri kohët e fundit ka qenë i gjallë. Nga Kamenica, me prejardhje nga Ogoshti. Përndryshe një diplomat i madh.

Kemi punuar bashkë me të ndjerin Toma Sekuliq, kemi, kemi qenë shoqëri. Dhe ai, unë, Ratko Bozhoviq dhe një shqiptar nga ministria, nga Sekretariati për punë të jashtme atëherë. Kemi qenë në delegacionin që ka shkuar në Tripoli, ku kemi nënshkruar marrëveshjen për punësim të punëtorëve tonë mjeksor në Libi. Kjo ka qenë në vitin '80. Më kujtohet, atëherë vjen një, vjen një urdhër që të kursehet. Dhe ne i kemi blerë biletat, i kemi bërë gati çantat, por Xhavit Nimanit, atëherë ka qenë kryetar i Kosovës. Ai ka dëgjuar që një delegacion po shkon dhe thirr që të zvogëlohet numri. Dhe na heqin mua dhe këtë Aliun, si është, Alia është quajtur apo nuk po më kujtohet tani. Neve dyve na heqin.

Dhe çfarë të bëjmë, shkojmë ne te Xhaviti (qesh). Dhe shkojmë ne te Xhaviti. Na pranon kryetari. Dhe kështu, po shiko kursimi, shiko këtë, ne i kemi blerë biletat, me të vërtetë i kemi blerë biletat, i kemi bërë gati çantat, vaksinat i kemi marr, të gjitha. Dhe ai thotë, "Hajt, rruga e mbarë ju qoftë." (qesh) Është thënja e famshme në Kosovë, që thotë, "Sipas nenit të Xhavit Nimanit." Edhe pse nuk ekziston në ligj, thuhet sipas nenit të Xhavit Nimanit. Kështu ne, Ramadan, Ramadan është, unë dhe Ramadani kemi shkuar kështu, në Libi sipas nenit të Xhavit Nimanit (qesh). Dhe atëherë, aty kam, kam parë mjaft gjëra.

Kam qenë edhe në Garijano, atje kanë, atje ka punuar Ramiz Sadiku, punëtorët e Ramiz Sadikut. Bash në shkretëtirë ka qenë ajo. Kjo më kujtohet. Pastaj kemi fluturuar me aeroplan prej Tripolit në Bengazi, atë, atë verë. Ja unë kam fluturuar, nuk e di sa dhjetra mijëra kilometra, gjashtë herë kam qenë në Amerikë. Çfarë të ju them? Por atë fluturim kurrë nuk do ta harroj. (qesh) Çdo gjë ndryshe prej neve, unë nuk jam racist, e ata që i kanë bartur çantat, ata të cilët këtu i bartin çantat atje vozisin (qesh). E atje, e ata që këtu vozisin, kështu drejtonin, atje i bartnin çantat, e dini. E tmerrshme, e pabesueshme.

Përherë të parë e kam parë botën, dhe pastaj çdo gjë ka qenë ndryshe. Dhe aty kam, unë kam, Selimi është autor, Selimi dhe një Snezhana, kolege e jona Haxhibulliq, janë autorë të Ligjit për marrëdhëniet e punës në Kosovë. Në atë kohë unë kam qenë autor i Ligjit për punësim në Kosovë. Pra, edhe këtë kontribut e kam dhënë për Kosovën. Atëherë Federale, Qeveria Federale ka qenë atëherë Jugosllavia dhe atje ne kemi shkuar, atje jemi edukuar. Në Beograd. Selimi dhe unë atëherë rrinim ulur në tren, ndoshta më vonë ka ardhur aeroplani. Ka qenë aeroplani për një kohë, Prishtinë, Beograd - Prishtinë.

Por treni, uleshim në mbrëmje ora njëmbëdhjetë, dhjetë në njëmbëdhjetë, në dhjetë e tridhjetë, dhe në mëngjes në ora pesë mërrin atje. Ka qenë shumë, shumë, shumë interesante. E unë kam, unë kam, kam, kështu dhjetëra inçizime, në Radio Prishtinë, të miat. Në dritën më të madhe kam inçizuar me orkestrin e Isak Muqollit. Ata janë muzikantë të shkëlqyer. Por ka, kishte diçka që nuk më pëlqente. Ato aranzhime kanë qenë shqiptare. Dhe kur është muzika në pyetje, rrallë kush mund të ik nga e vetja.

Kështu që e kam një numër të këngëve, jo vetëm unë por edhe të tjerët që kanë inçizuar, ke aranzhmane shqiptare për muzikën serbe.

Vetëm që këndohet në gjuhën serbe, ky ka qenë një asimilim i pabesueshëm. E kur kam ardhur unë në pozitë, kur kam qenë sekretar i komitetit, unë kam qenë përgjegjës për Radio Prishtinën. Si, si politikan për partinë në Prishtinë. Dhe unë e kam shfrytëzuar atje atë fuqinë të kërkoj që të krijohet orkestri serb. Pasi që ka ekzistuar ai turk, ka ekzistuar ky, shqip, në shqip ka luajtur shqiptare dhe serbe. Dhe pastaj unë kam kërkuar dhe kam arritur dhe është themeluar ai orkestri serb.

Atëherë kur kam qenë unë, është themeluar orkestri serb dhe atje kam takuar njerëz të mrekullueshëm të cilët kanë ndihmuar e ata, ata nuk janë më, gazetarë...

Erëmirë Krasniqi: E çfarë këngë ju keni kënduar? Dhe ato i keni inçizuar?

Momçillo Trajković: Po të Kosovës, këngët e vjetra kosovare. Po po këngët e vjetra kosovare.

Erëmirë Krasniqi: A keni inçizime ende?

Momçillo Trajković: Unë nga Radio Prishtina e kam vetëm një inçizim. Tani që kam publikuar, unë e kam publikuar CD-në time, a e shihni atë bozhurin atje? {me shikim tregon ku është} Eh aty është, aty është, e kam pasur koncertin aty unë.

Erëmirë Krasniqi: (qesh)

Momçillo Trajković: Para tre muajve, po. E kam mbajtur koncertin tim. Katërqind njerëz, salla përplot. Unë jam, tani do t'ua lëshoj, ja ejani ju, ejani të shihni, aha mirë, ja pastaj. Kështu, pra, kam hyrë, kam shkuar dhe kam kënduar, dy orë e gjysmë askush nuk ka lëvizur. Por mirë, ata mund të fishkëllenin, unë i kam ftuar. Ju mund të fishkëlleni, askush nuk ka fishkëlluar, të gjithë kanë duartrokitur dhe të gjithë kanë qenë shumë të kënaqur. Edhe sot flitet për atë koncertin. Dhe shumica nuk e dinë që unë merrem me këtë. Unë tani po e përgadis koncertin në Beograd, në sallën KomBank.

Ajo është ish Dom Sindikata, një mijë e gjysmë njerëz. Unë po përgaditem, ja sot kemi filluar përgaditjet po punojmë. Më katër maj, më katër maj, pra për tre muaj. Do të jem, unë do tambaj koncertin në Beograd, ja kështu si jam po shkoj të, të këndo. Unë jam, unë nuk jam profesional por kam unë, atë që di ta bëj, do ta bëj dhe do të kem musafirë, do të kem, do të jetë ajo. Do të jetë kënga kosovare në, në Beograd. "Nostalgjia kosovare" kështu quhet dhe ajo është, për mua fare, i shoh komentet. Unë e vendos atë në Facebook, njerëzit janë të kënaqur jashtë mase, askujt, askush nuk më ka, njëri ashtu diçka rrugës...

Të gjithë dhe mijëra komente, “Sikur të kishte politikanë të tillë që janë njerëz normal” e dini çfarë, dhe pastaj mua, pastaj ai koncerti im nuk është vetëm këndim klasik por ka edhe bisedë, tregim. Për secilën këngë unë tregoj si kam ardhur deri te ajo këngë. Pytja e parë atje “Nga” thotë, “politika dhe muzika?” Kjo është pyetja e parë. Çfarë lidhje? Po unë kam lidhje, i është, është një i madh i famshëm, filozof i vjetër kinez, Konfuçi ka shkruar për këtë. Ka, ka shkruar një trakt për politikën dhe muzikën. Ai, ai i ka gjetur pikat e përbashkëta ndërmjet muzikës dhe politikës, e cilat janë pikat e përbashkëta?

Njëra dhe tjetra i tërheqin njerëzit, me tërheqjen e njerëzve, por jo në atë kuptimin negativ e dini. Dhe kështu pastaj unë filloj. Babai im ka kënduar, ai më ka mësuar, ai më ka mësuar. E merr, kur ai vinte nga, nga terreni, aty diku ka qenë ajo, këtu {tregon drejtimin} diku ka qenë ajo dhomë. Ai më merr në prehër, më vendos {prek gjurin e vet} dhe tani ai më ka mësuar të këndoj edhe këngët shqiptare. Unë mundem, ta këndoj këngën shqiptare, “Ani more nuse, ani qafë gastare/ a po doni rruza, a po doni pare” apo ajo “une dola me ni bashqe, me ni lule” dhe kështu me radhë ka. Apo atë, unë shumë i dua dhe shumë i kam dashur, dëgjova që është, që është vrarë Bicuri, Esat Bicuri. “O zambaku i Prizrenit, aman, man, amane... aman, aman...” dhe këto kështu, apo Ilfeta Rafuna, unë kam kënduar me Ilfete Rafunën, nuk e di a keni dëgjuar për Ilfete Rafunën? Ajo është e re, po tash është plakur më, ajo është në Amerikë. Ne kemi kënduar së bashku në Dom Jed.

[Intervista është ndërprerë për shkak të problemeve teknike]

Pastaj kemi shkuar ta prezantojmë Kosovën në Nish, bashkë kemi kënduar në Nish. E Granit Miftari, për operë, ai ka qenë producent, Granit Miftari, Granit Miftari, ai ka qenë producent në Radio Prishtinë. Përndryshe këngëtarë i operas. Ai është me, nuk e di, nuk e kam parë moti.

Erëmirë Krasniqi: Më flisni rreth këngëve tuaja tradicionale, lidhur me çka janë?

Momçillo Trajkoviq: Po çka ja, e kam unë një emision, shumë këngë kosovare dhe serbe i kanë marrë të tjerët. Për shembull Vranje, njëri prej këngëtarëve më të mirë të këngës serbe është Stanisha Stoshiq. Nuk e di a keni dëgjuar për të, nuk keni dëgjuar? Ai ka vdekur. Përndryshe, i ka inçizuar dy këngë kosovare, dhe ato janë bërë të Vranjës. Unë ato po i inçizoj dhe po i kthej të jenë kosovare. Për shembull, “A kude si bila mori kara Koco” [Nga ke qenë moj kara Koco], është një këngë e mrekullueshme, unë e kam inçizuar për Radio Prishtinën. Kështu, edhe Stoshiq e ka inçizuar, përndryshe kara Koca është gjilanase, është këngë gjilanase. Ajo ka jetuar në Gjilan deri në vitin ‘37 dhe pasi që ai është nga Vranja dhe pasi është këngëtar i shkëlqyer, ai e inçizon. Dhe thonë këngë e Vranjës.

Më tutje, ai e ka inçizuar “Sinoćke te vide lele Zone” [Mbrëmë të panë moj Zone] është një, është edhe filmi për Zona Zamfirovën, është edhe filmi, Zdravko Shotra e ka inçizuar. E, aty, ajo Zona, Zona është, Zonën, Stevan Sremac që është shkrimtar i njohur serb e ka shkruar. Dhe aty, ai ka dëgjuar për Zonën në Prishtinë kur ka qenë mysafir tek Branislav Nushiq. Branislav Nushiq ka qenë konzul, konzul serb

në Prishtinë. Dhe kur Stevan Sremac, gjithashtu shkrimtar i madh ka ardhur tek ai, ata kanë, biseduar. Ai e ka treguar tregimin për atë Zonën për atë prishtinasen e bukur, e cila ka jetuar aty dhe gjithë fatin e saj. Dhe ai e shkruan dramën për teatër për të. Dhe këta e bëjnë tani filmin.

E në atë dramë është edhe kënga “Zone Zamfirovo” por pasi që Stanisha Stoshiq është nga Vranja, ai e ka inçizuar dhe kjo pastaj, dikush thotë se është nga Nishi, dikush thotë që është nga Vranja e ajo në fakt është këngë kosovare serbe nga Prishtina. Dhe ka anekdota, së fundi diku kam lexuar për atë Zonën, ajo pastaj ka shkuar, ka shkuar të jetoj në Prizren, e nuk e di, aty i ka vdekur burri e prej atje ka shkuar në Beograd dhe në Beograd ka vdekur, nuk e di, para të parës, luftës së dytë botërore. Përndryshe ajo ka qenë me të vërtetë një grua shumë e bukur. Dhe me këtë, me këtë merrem unë. Po mundohem, edhe më tutje po mundohem që këto, tek ne ekziston e ashtuquajtur kënga e festave, kjo këndohet nëpër festa.

Aty nuk ka shumë muzikë, aty “vlla” këngët shkojnë dhe unë tani për shembull e kam marrë këngën dhe e kam bërë këngën me aranzhim të ri, me të ri, ritmin e ri dhe kjo është tani, një këngë që e kam bërë tani, quhet “Sinoć konji ne dođoše” [Mbrëmë nuk erdhën kuajt]. E bëhet fjalë, përshkruan fatin e një vajze të bukur, bijën e pronarit e cila është dashuruar me shërbëtorin, Stojanin. Ai Stojani i ka ruajtur lopët, kuajt, ka korr, është ulur dhe në mbrëmje kur vinte, ai i lidh kuajt dhe shkon në shtëpi. E kjo gjithmonë e ka përcjellur, e bija e pronarit, e ka përcjellur. Kur vjen, ai djali i bukur, ajo shikon, dhe kështu ka qenë.

Një natë nuk është Stojani, nuk ka as kuaj, nuk është askush. Ai i shkreti ka shkuar në shtëpi, ato sofrat e dini, ne i kemi ato edhe shqiptarët e vjetër, i kanë, edhe ne i kemi, ato sofrat. Dhe i shkreti, aty pak bukë, kripë, ai han kurse ajo ka ardhur ta kërkoj. Dhe kur ka ardhur nën dritare, e sheh atë.

Të gjithë darkojnë, ai nuk darkon, ai *kaval*, e dini çka është *kaval*? Ai po bën kavall, e bën që, që të martohet. Po bëhet gati për martesë, ta grabis vajzën dhe ta vazhdoj lindjen. Unë e kam bërë atë këngën, dhe tani ajo është kënga më e popullarizuar. E jashtëzakonshme, nuk e di cilën, për dy-tri ditë rreth 30 mijë njerëz e kanë dëgjuar atë këngën.

Po, kështu që, po e them këtë. Me këtë, me këtë po merrem, po mundohem që, që të lë pas vetes diçka të tillë, që. Pastaj e kam këtë, kjo kënga për Stojanin nga Malet e Sharrit, është këngë, ja ku është [lëshon këngën]. Për Stojanin nga Malet e Sharrit, kjo këngë është nga periudha turke. Ne me aranzhim e kemi sjellë në këtë kohë, kështu që ai Stojani është në fakt secili serb, Stojani nga Malet e Sharrit është çdo serb që sot jeton në Kosovë dhe i cili është dashur të largohet. Por kur një mik i imi shqiptar e ka dëgjuar këtë, ai kafilluar të qaj. Sepse ka mundur, ky Stojan ka mundur të quhet edhe Rifat apo nuk e di se si të quhet. [kënga ende vazhdon në prapavijë] Unë po këndo. Ka edhe video spot, ja është edhe video spoti.

Po, pra ai është, ai është fati ynë, fati ynë i përbashkët. Dhe po them, kur e ka dëgjuar, njeriu filloi të qaj. Çka është thotë, ai e ka gjetur veten aty, e ka gjetur veten. Dhe ja me këtë, me këtë po merrem dhe me këtë po kënaqem. Dhe jam i aftë mund të, të dal para mijëra njerzve dhe të këndo. Unë nuk kam emocione, kjo është e mirë, unë nuk kam emocion. Sikur me juve që po flas tani, unë mund të dal para mijëra njerzve, dhe të mos ma ndjej. Sepse ajo që dua ta bëj, e di që do ta bëj në mënyrë korrekte. Atë që unë e bëj si amater, ajo nuk është, shumë profesional nuk mund ta bëjnë. Kështu që, pse jo?

Erëmirë Krasniqi: Faleminderit shumë. A keni edhe diçka të shtoni për fund?

Momçillo Trajković: Paj unë, unë jam, unë jam tregim i pa treguar (qesh). Nuk mund të, unë nuk e di, unë aq shumë kam jetuar, unë kam jetuar aq gjatë, ma kujtoni. E po, ju kam thënë, çfarë ishte Rahovecin diçka. Tani do të, tani Rahovecin do ta, Rahovecin, çfarë kam dashur për Rahovecin... kam harruar, pak më herët thash Rahovec.

Kaltrina Krasniqi: Po po, por nuk e di pse, pse e keni atë, pse?

Erëmirë Krasniqi: Kjo ka qenë qëmoti me babain tuaj?

Momçillo Trajković: Jo, jo nuk ishte me babain tim. Ka lidhje, që, kur kam qenë duke folur dhe e kam përfunduar. Kur kam qenë nën dritaren e shtëpisë së Ramush Haradinajt, pas luftës. Dhe kur e kemi xhiruar atë emisionin, me atë gazetarin. Më gjuhën shqipe që e di unë futem (smeje se) deri nën shtëpi në, në Glogjan. Atje shkojmë dhe e inçizojmë ne gjithë atë, ne të gjitha i kemi inçizuar. Dhe i shkreti, ai pastaj ka vdekur dhe atë inçizim tani nuk mund ta gjej unë. Unë kam folur për Ramushin, më ka ftuar në një rast Ramushi që të shkoj tek ai, unë kam shkuar. Në kabinetin e tij aty, ku e ka partinë.

Dhe unë i flas atij, dhe i them, “Ja po të lajmroj, ‘eja t’i them disa detaje unë.” Dhe unë i’a them detajet. Ku e ka shtëpinë, ku kam mbërritur, askush nuk më ka pyetur. “Po të kisha bombë, kam mundur ta (qesh) gjuaj bombën dhe të mos jesh më.” Ai qesh dhe thotë, ka folur ai serbisht, thotë, “Si po e flas gjuhën serbe?” I them “Shkëlqyeshëm, katër.” E kur thotë, “Si shkëlqyeshëm, katër?” “Katër për dituri a shkëlqyeshëm që po mundohesh” (qesh) Mua, të ju them, njëri prej njerzve politikanë të rrallë, i cili po mundohet, këta tjerët nuk dëshirojnë.

Thaçi për shembull, nuk dëshiron të flet serbisht, nuk dëshiron. Unë me të kam folur njëqind herë. Të ju tregoj edhe këtë, kur kam qenë pas luftës, na thërrasin Amerikanët neve në, në Budapest. Politikanët shqiptarë dhe serb, të bisedojmë. Shkojmë ipeshkvi dhe unë dhe ati Sava Janjiq, e këndej Ibrahim Rugova, Ramushi, Thaçi, Ske, ky Surroi dhe një numër. E kemi pasur tavolinën e rrumbullakët për herë të parë amerikanët, ata dëshirojnë poena, e dini. Dhe i përfundojmë bisedimet dhe tash, Alen Kasov ka qenë kryesuesi i fondacionit Karnegi. Ai ka vdekur, i shkreti.

Thotë, “A do të pranoni sikur të shkonim tani në konferencë për shtyp?” E shumë shkrimtarë, sepse kjo ka ndodh menjëherë pas luftës, po i zhvendos Serbia shqiptarët. Unë them, “Dua.” Shkojmë, ulemi. Afër meje Rugova, Thaçi në fund, mua më shumë më ka pëlqyer të ulem afër Rugovës, sepse Rugovën më shumë e vlerësoj se atë, e dini. E Kasv nga kjo anë. Dhe po e hap Kasov konferencën, po fillojnë. Dhe pyetja e parë mua, njëri që ishte korrespondent nga Beogradi, si quhet, a është nga Kohe Ditore, si quhet?

Kaltrina Krasniqi: Janë disa.

Momçillo Trajković: Njëri që flet serbisht shkëlqyeshëm. Tash ka qenë në, kur ka qenë Vuçiqi ka bërë pyetje. Dhe më thotë mua, pyetja e parë mua, më thotë “Zotëri Trajković, si do të ktheheni ju tani në shtëpi kur ju shohin që jeni ulur me Ibrahim Rugovën?” Mua më punojnë klikerat shpejtë, dhe them, “E dini çfarë, nëse edhe zotëri Rugova” e ka absurd të vështirë, tani më vjen keq, pastaj, më ka ardhur keq për atë që kam thënë, por është dashur të nxirrem, “Nëse Millosheviqi ka mundur të flas me zotëri Rugovën, pse unë të mos mund të flas me fqinjin tim Ibrahim Rugovën?” (qesh)

Ka shumë anekdota të tilla, por kjo për Rahovecin çfarë ishte nuk më kujtohet, por ka qenë diçka interesante.

Kaltrina Krasniqi: Ju faleminderit shumë.

Momçillo Trajković: Nuk ka gjë. Unë jam njeri me 69 vjet dhe shumë mirë mbaj në mend.

Kaltrina Krasniqi: Ka qenë interesante. Më të vërtetë ka qenë kënaqësi.

Momçillo Trajković: Edhe për mua ka qenë kënaqësi të bisedoj me juve, e nëse ju nevojitet edhe diçka, jam i gatshëm që edhe kaq, edhe sa kohë që dëshironi të ju kushtoj, që të keni, gjithçka si duhet.